



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 424 Akti**

**Nr. 423 Vendimi**  
**Tiranë, më 15.7.2021**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Relatore
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 14.7.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Elida Hoxhaj**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elida Hoxhaj me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Prokurorisë (në vijim KLP).
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të germës “b”, të pikës 7, të nenit 3 dhe pikës 9, të nenit 3, të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit znj. Elida Hoxhaj, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.
4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 23.12.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Elida Hoxhaj, si dhe caktoi kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
5. Në datën 9.1.2020 subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në datën 10.1.2020, deklaroi përmes postës elektronike marrjen dijeni për njoftimin dhe trupin gjykues, si dhe mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
6. Komisioni, në datën 24.6.2021, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Elida Hoxhaj, për të tria kriteret e rivlerësimit: për pasurinë, figurën dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; si dhe (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e saj brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Në datën 28.6.2021 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; si dhe (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 10 ditëve. Brenda afatit të caktuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ në mënyrë elektronike dhe zyrtare.
8. Trupi gjykues, në datën 12.7.2021, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Elida Hoxhaj, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke e njoftuar në të njëjtën datë me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 14.7.2021, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**9.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Elida Hoxhaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

**10.** Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Elida Hoxhaj. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 14.7.2021, për të rifilluar në datën 15.7.2021, për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**11.** Znj. Elida Hoxhaj ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**12.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese<sup>1</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

### **A. RIVLERËSIMI I PASURISË**

Në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti ka deklaruar:

---

<sup>1</sup> Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

**1. Shtëpi banimi, në zotërim, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, në të cilën subjekti banon që nga martesja. Banesa është blerë nga babai i bashkëshortit, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* regj., datë 31.1.1967, në vlerën 25.000 lekë. Më pas, bashkëshorti dhe familjarët e tij, prindërit dhe vëllezërit, që kanë jetuar në këtë banesë, kanë ndërtuar shtesa anësore deri në vitet 1998 - 1999, për të cilat është aplikuar pranë ALUIZNI-t Fier për legalizimin e tyre në datën 2.2.2015 (e paregjistruar). Nuk është bërë ndonjë vlerësim i banesës, pasi është e paregjistruar. Pasuri trashëgimore, e pandarë.**

**1.1** Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar dokumentacionin mbështetës për këtë pasuri<sup>2</sup>, si vijon:

- Vërtetim datë 17.10.2016, e ZVRPP-së Fier, ku konfirmohet se në emër të shtetasve B., Elida dhe J. H. nuk rezultojnë pasuri të regjistruara. Në vërtetim sqarohet se ZVRPP-ja nuk disponon regjistrimet e kryera para vitit 1997, pasi dokumentacioni është djegur gjatë trazirave të këtij viti.

- Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., me palë shitëse M. Z. dhe palë blerëse D. H. . Çmimi: 25.000 lekë, autentifikuar me nr. \*\*\* rep., datë 31.1.1967. Së bashku me kontratën është depozituar edhe vërtetimi i datës 25.1.1967, autorizim i datës 28.1.1967, ku shtetasi M. Z. nga lagja “\*\*\*\*” autorizohet të shesë shtëpinë që përbëhet nga 2 dhoma e një kuzhinë te shtetasi D. H. .

- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016, mbi aplikimin për legalizim të objektit pa leje, i cili konfirmon se shtetasi B. D. H. ka nënshkruar deklaratën për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje me drejtorinë e ALUIZNI-t Fier. Objekti figuron me këto të dhëna: nr. \*\*\*prot.; objekti: shtesë anësore, \*\*\*\*, Fier, nënshkruar në datën 2.2.2015. Bashkëlidhur deklaratë për përfshirje në procedurat e legalizimit, datë 2.2.2015, nga shtetasi B. H. . Shtesë anësore në ndërtim me leje; ndërtim i ngritur në vitet 1998 - 1999, në lagjen “\*\*\*\*”, Fier; certifikatë familjare e datës 2.2.2015; planimetria e katit; skicë fushore; deklaratë personale datë 20.8.2015; deklaratë për zbatimin e planit rregullues, datë 20.8.2015; formular i të dhënave të ndërtimit pa leje, datë 20.8.2015; numri i kateve 1; fotot përkatëse; planimetria e katit përdhe; sipërfaqe e ndërtimit 126,1 m<sup>2</sup>; sipërfaqe funksion banimi 126,1 m<sup>2</sup>; certifikatë familjare datë 12.11.2014, në bazë të regjistrimit \*\*\* +1/2 i viteve 1950-1974. Vërtetohet se shtetasi D.H. është vendosur në Fier më 23.5.1967, sipas regj. fshati R. 1/1; certifikatë familjare lëshuar në datën 27.4.2015, ku vërtetohet përbërja familjare në datën 1.8.1991.

**1.2** ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: (i) nuk është e qartë vlera 3.600.000 lekë, që subjekti ka deklaruar për banesën 1-katëshe në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës 2003; (ii) mosdeklarim në deklaratën e rivlerësimit i të dhënave fizike të banesës në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, konkretisht i sipërfaqes së ndërtimit, vlerës së investuar, burimit financiar të përdorur, kohës së ndërtimit të katit të dytë dhe pjesës takuese të bashkëshortit të subjektit në këtë banesë, si dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, preventiv/situacion; (iii) mosdeklarim në deklaratën e interesave private të vitit 2015, i aplikimit për legalizimin nga shtetasi B.H., për legalizimin e banesës 2-katëshe, me sipërfaqe banimi 263,4 m<sup>2</sup>.

### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit**

**1.3** Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 (kohë në të cilën ushtronte detyrën si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rethit Fier), me përshkrimin: “*Banesë 1-katëshe e përbërë prej 2 dhomash e një kuzhinë, me sip. 120 m<sup>2</sup>.*”

<sup>2</sup> Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

*Nën të njëjtën çati ndodhet edhe dhoma e kunatit tim, i cili ndodhet prej 5 vitesh në Greqi. Vlera: 3.600.000 lekë. Burimi: e blerë në vitin 1967. Kursime familjare”.*

**1.4** ASHK-ja, Drejtoria e Përgjithshme, Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2020, informon se shtetasi B. D. H. rezulton aplikues në procesin e legalizimit, regj. dek. \*\*\* prot., datë 2.2.2015, shtesë me dokument pronësie, Qarku Fier.

**1.5** UKT-ja, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 14.5.2020, informon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të saj nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata për shërbime Ujësjellës-Kanalizime Tiranë. Subjekti ka depozituar kopje të librezës së UK-së Fier, me nr. kontrate \*\*\*.

**1.6** FSHU-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2020, informon se në emër të shtetasit B.H. identifikohen 7 (shtatë) abonentë me kontratat e furnizimit me energji elektrike me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Subjekti ka deklaruar se bashkëshorti i saj është abonent familjar i OSHEE-së për furnizimin me energji elektrike të kësaj pasurie. Gjithashtu, ka deklaruar se ajo dhe bashkëshorti nuk kanë asnjë lidhje me kontratat e furnizimit me energji elektrike të abonentëve të tjerë me të njëjtin emër B.H., të identifikuar me shkresën e FSHU-së. Subjekti ka depozituar kopje të librezës për pagimin e energjisë elektrike.

**1.7** Subjekti, për këtë pasuri, është pyetur disa herë nga Komisioni për mënyrën e përfitimit në emër të bashkëshortit të saj, burimin e krijimit dhe zhvillimin e ndërtimit. Ndër të tjera, subjekti ka deklaruar<sup>3</sup> se: *“Shtëpia është blerë nga babai i bashkëshortit, sipas kontratës së shitblerjes nr\*\*\*regj., datë 31.1.1967, në vlerën 25.000 lekë. Më pas bashkëshorti dhe familjarët e tij, të cilët kanë jetuar në këtë shtëpi, kanë ndërtuar shtesa anësore deri në vitet 1998 - 1999, për të cilat është aplikuar pranë ALUIZNI-t Fier për legalizimin e tyre në datën 2.2.2015. Aplikimi është bërë nga bashkëshorti im B. H., pasi në këtë kohë vetëm ne jetojmë faktikisht në këtë banesë. Për efekt deklarimi, në vitin 2004 nuk kemi kryer ndonjë vlerësim me ekspertë të fushës së banesës, por kemi vlerësuar vetë se banesa kishte vlerë tregu 3.600.000 lekë (duke konsideruar sipërfaqen në fakt të banesës dhe çmimin e shitjes të banesave të ngjashme, për aq sa ne kishim dijeni). Për shkak se ndërtimi shtesë është kryer në mënyrë informale, familjarët e bashkëshortit nuk kishin të ruajtura faturat apo përlllogaritjet e shpenzimeve të kryera për ndërtimin informal.*

*Njolla e objektit prej 131,7 m<sup>2</sup> ka rezultuar pas matjeve në terren nga specialistët e ALUIZNI-t dhe është më e madhe nga sa është deklaruar prej meje, pasi në këtë sipërfaqe përfshihet edhe dhoma e kunatit. Meqenëse vëllai i bashkëshortit jeton prej vitesh në Greqi, aplikimi për legalizimin e shtëpisë është bërë nga bashkëshorti im B. H. (i cili kishte rënë dakord për kryerjen e këtij veprimi, paraprakisht me vëllanë e tij). Sqaroj se edhe banesa ekzistuese është bashkuar me ndërtimin e ri. Banesa ekzistuese nuk ishte regjistruar në ZVRPP-në Fier, pasi kjo zyrë nuk dispononte dokumentacion ligjor para vitit 1997 dhe për efekt dokumentacioni është zgjedhur deklarimi pranë ALUIZNI-t për të regjistruar banesën”.*

Në vijim të përgjigjeve në pyetësorë, subjekti ka sqaruar se *sipërfaqe banimi është vetëm kati përdhe me sip. 128,6 m<sup>2</sup>, sipas certifikatës së pronësisë, ndërsa kati i parë me sip. 78,3 m<sup>2</sup> është çatia e objektit, e cila nuk shfrytëzohet për banim. Nënçatia nuk është dhe nuk mund të shërbejë si sipërfaqe banimi dhe, për këtë arsye, duke mos e konsideruar ndërtim, bashkëshorti nuk ka aplikuar për regjistrimin e saj, por vetëm të shtesave anësore. Gjatë verifikimit dhe matjeve në terren nga specialistët e ALUIZNI-t, çatia është përcaktuar si kati i parë i objektit (kati i dytë, e cila në dokumentacionin teknik pasqyrohet kati i parë).*

<sup>3</sup> Me pyetësorët nr. 1, datë 9.1.2020; nr. 2, datë 1.4.2021; nr. 3, datë 5.5.2021; dhe nr. 4, datë 7.5.2021.

Subjekti<sup>4</sup> ka depozituar praktikën e legalizimit të kësaj pasurie, ku nga verifikimi i dokumentacionit ka rezultuar se pasuria është formalizuar me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 28.5.2020, në emër të bashkëshortit të subjektit, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 380 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtimi 126,8 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe totale ndërtimi 205 m<sup>2</sup>, dy kate mbi tokë. Pasuria (sipas kartelës së pasurisë) rezulton e regjistruar në hipotekë në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj. Edhe nga korrespondenca e administruar<sup>5</sup> rezulton se bashkëshorti i subjektit ka aplikuar për legalizim të shtesës së godinës.

**1.8** Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, subjekti ka sqaruar *se janë kursimet familjare të familjes së bashkëshortit ndër vite, para fillimit të detyrës nga ana e saj.*

Komisioni i ka kërkuar<sup>6</sup> subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues mbi të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e pasurisë. Subjekti ka deklaruar se: *“Kjo pasuri nuk është objekt i ri, por është blerë nga prindërit e bashkëshortit që prej vitit 1967, sipas dokumentacionit të dërguar në përgjigje të pyetësorit nr. 2. Shtesat anësore kanë qenë shtesa të domosdoshme për nevojat jetike, ndërsa çatia e objektit (shtëpisë) është ndërtuar në vitet 1998 - 1999.*

*Për sa i përket të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e çatisë së shtëpisë, e cila në dokumentacionin teknik pasqyrohet kati i parë, burimi i krijimit të tyre janë kursimet familjare të familjes së bashkëshortit në vite.*

*Në vitet 1994 - 1995, bashkëshorti im B. H. ka sjellë nga Turqia pjesë këmbimi për autobuza e traktorë të ish-ndërmarrjeve të naftës, pjesë e ‘\*\*\*’ sh.a., konkretisht për ‘\*\*\*’ (e njohur edhe me emrat Ndërmarrja e Furnizimit Teknik ose Baza e Tubove), Parkun e Mallrave të Naftës Patos, si dhe TEC Fier dhe pagesa është kryer në llogarinë e tij pranë BKT-së, dega Fier.*

*Sipas bashkëshortit tim, shuma e xhiruar nga ‘\*\*\*’ sh.a. në këtë periudhë në llogarinë e tij në BKT, dega Fier, shkon rreth 2.000.000 lekë.*

*Për shkak të periudhës së gjatë që ka kaluar nuk disponojmë dokumentacion për shumat e kaluara në llogarinë e bashkëshortit B. H. dhe për këtë arsye është kërkuar informacion në Arkivën Shtetërore Vendore, Lushnje, ‘\*\*\*’ sh.a. dhe BKT, dega Fier, në lidhje me pagesat e kryera për llogari të bashkëshortit B. H. .*

*Sipas shkresës së Arkivit Shtetëror Vendor, nga kërkimet e bëra në dokumentacionin e këtij të fundit nuk u gjetën të dhënat e kërkuara. Sipas Regjistrimit të Hyrjes së Fondeve (dokumenteve) në ASHV-në Fier nuk kemi të regjistruar dokumentacion të ‘\*\*\*’, ‘\*\*\*’ sh.a. (Drejtoria e Përgjithshme e Naftës dhe Gazit Patos) dhe dokumentet si: fatura, mandatpagesa, mandatarkëtimi, fletë hyrje-dalje etj., ruhen në sektorët përkatës të subjektit shtetëror.*

*Sipas shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2021, të ‘\*\*\*’ sh.a., kjo shoqëri nuk ka të ruajtura në arkivën e vet kopje të transaksioneve bankare të një periudhe kaq të gjatë kohore. Vetë legjislacioni shqiptar kërkon ruajtjen e dokumenteve shoqërues me efekt të kontrollit financiar për një periudhë deri në 10 vjet.*

*Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2021, të Bankës Kombëtare Tregtare, dega Fier, për periudhën 1994 - 1995 nuk disponojmë dokumentacion. Për të provuar sa më sipër, në mungesë të dokumentacionit, ju vëmë në dispozicion deklaratat noteriale të shtetasve P. B. dhe E. L. ”.*

**1.9** Për sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se subjekti, me korrespondencat e vendosura në dispozicion, duket se nuk ka arritur të provojë me dokumentacion punësimin e bashkëshortit dhe të ardhurat e përfituara prej tij. Deklaratat noteriale të shtetasve P. B. dhe E. L. duket se

<sup>4</sup> Me pyetësorin nr. 4, datë 7.5.2021.

<sup>5</sup> Shihni përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 24.8.2017, të ALUIZNI-t në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>6</sup> Pyetësor nr. 3, datë 5.5.2021, dhe dokumentacioni mbështetës.

provojnë në mënyrë indirekte punësimin e bashkëshortit, por jo vlerën e përfituar nga ky punësim.

### **Në lidhje me vlerën e mundshme të investimit në këtë pasuri**

**1.10** Në vijim të deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, nga ku u konstatua se banesa me sip. 65,5 m<sup>2</sup> është blerë në vitin 1967 dhe legalizimi është kryer për një banesë 126,8 m<sup>2</sup> + 78,3 m<sup>2</sup> (çatia), Komisioni ka vlerësuar të kryejë një analizë për koston e mundshme të ndërtimit, duke u bazuar në çmimet/kostot e Entit Kombëtar të Banesave, megjithëse subjekti ka depozituar<sup>7</sup> një raport vlerësimi se sa mund të ishte një vlerë e mundshme e ndërtimit të çatisë, në të cilën inxhinieri i licencuar ka pasqyruar preventivin për investimin në vlerën 298.417 lekë.

Komisioni ka vlerësuar të bazohet në kostot e ndërtimit të EKB-së në vitin 1998<sup>8</sup>.

**1.11** Meqenëse sipas lejes së legalizimit dhe kartelës së pasurisë, sipërfaqja e katit përdhe është 126,8 m<sup>2</sup>, atëherë shtesat anësore të kryera janë 61,3 m<sup>2</sup> (sipërfaqe totale 126,8 m<sup>2</sup> – sipërfaqe ekzistuese 65,5 m<sup>2</sup>) dhe çatia (kati i parë) prej 78,3 m<sup>2</sup>.

**1.12** Kosto e katit të parë/çatia është vlerësuar të merret me koston e karabinasë. Kjo, për faktin se shtesat janë ndërtuar mbi një objekt ekzistues (prej vitit 1967) dhe se çatia nuk është një kat i plotë, që do të thotë se ky investim nuk mund të ketë të njëjtën kosto me një ndërtim të ri që fillon prej themeleve. Nga eksperiencia e Komisionit në vendimmarrjet e mëparshme<sup>9</sup>, kostoja e karabinasë është vlerësuar 30 % e kostonë së ndërtimit.

**1.13** Sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 28.4.1999, për kostot e ndërtimit, vlera e investimit rezulton si vijon:

<b>Përshkrimi</b>	<b>Sipërfaqe m<sup>2</sup></b>	<b>Kosto sip. ndërtimi lekë/m<sup>2</sup> në qytetin e Fierit</b>	<b>Vlera</b>
Kati përdhe	61,30	21,400.00	1,311,820
Kati parë (çatia)	78,30	6,420.00	502,686
			<b>1,814,506</b>

**1.14** Komisioni kreu analizën financiare, duke marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga pjesëtarët e familjes, të cilat janë dokumentuar nga institucionet publike.

Shuma e të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i subjektit dhe vjehrra janë në vlerën 229.440 lekë. Për bashkëshortin konfirmohen nga ISSH-ja të ardhura vetëm për vitet 1980 - 1993, në vlerën totale 155.222 lekë dhe për vjehrrën e subjektit të ardhura nga pensioni në vlerën 74.218 lekë për vitet 1988 - 1995. Nisur nga fakti se subjekti është martuar në vitin 1996, Komisioni, në përlllogaritjet e kryera, ka përfshirë vetëm të ardhurat nga punësimi i saj për 2 vite (1996 - 1998), në vlerën 686.711 lekë. Në përfundim, totali i të ardhurave (subjekti, bashkëshorti dhe vjehrra) rezulton në shumën 916.151 lekë, nëse zbresim edhe shpenzimet e jetesës (përlllogariten 66 % e të ardhurave = 604.660 lekë), balanca negative rezulton në vlerën 1.503.015 lekë.

**1.15** Komisioni, mbi konstatimet e rezultuara nga hetimi, i kërkoi shpjegime subjektit, pasi dukej se: (i) nga analiza financiare duket se subjekti dhe familjarët e saj nuk kanë pasur mundësi në shumën 1.503.015 lekë të investojnë në këtë pasuri, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare; (ii) nuk ishte deklaruar saktë sipërfaqja e ndërtimit të banesës objekt hetimi administrativ, vlera e shpenzuar për ndërtimin e saj dhe burimi i krijimit të shumës së shpenzuar

<sup>7</sup> Me pyetësorin nr. 3, datë 5.4.2021.

<sup>8</sup> EKB-ja ka të njëjtën kosto ndërtimi edhe për vitin 1999.

<sup>9</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 27.7.2020.

për ndërtim; (iii) në deklaratën për vitin 2015 nuk ka deklaruar aplikimin për legalizimin e ndërtimit informal, banesë me 2-katëshe, me sipërfaqe banimi 263,4 m<sup>2</sup>.

**1.16** Mbi konstatimet e Komisionit, subjekti ka parashtruar se pasaktësitë në lidhje me sipërfaqen e ndërtimit të kësaj banese kanë të bëjnë me faktin që në deklarime i ishte referuar gjendjes faktike të objektit dhe sipërfaqes që shfrytëzohej për banim nga familja e saj, duke bërë një përlogaritje të sipërfaqes, sipas matjeve (siç duket jo shumë precize) të kryera prej tyre. Edhe ambientet janë deklaruar ashtu siç shfrytëzoheshin për nevojat familjare të përbëra nga dy dhoma e një kuzhinë, ndërsa sipërfaqja e saktë e saj ka rezultuar pas matjeve të kryera në terren nga specialistët e ALUIZNI-t.

**1.16.1** Aplikimi për legalizimin e ndërtimit informal nuk është deklaruar në deklaratën për vitin 2015, pasi këtë banesë e ka deklaruar si pasuri të saj në deklaratën e parë të vitit 2003, kohë kur ka qenë me detyrë oficerë e policisë gjyqësore dhe nuk bëhet fjalë për një objekt të ri. Banesa ishte e njëjtë, pa asnjë investim që nga deklarimi i parë dhe në lidhje me këtë banesë nuk kishte ndryshime në regjistrat publikë. Gjatë viteve, pas deklarimit të parë të subjektit, nuk ka pasur shtesë apo pakësim të kësaj pasurie dhe për këtë arsye ka vlerësuar se kërkesa për legalizim nuk është objekt deklarimi (në kushtet kur ekzistenca e këtij objekti ishte deklaruar në DPV-në e vitit 2003). Në dokumentacionin e dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, për efekt të këtij procesi, kishte paraqitur edhe dokumentacionin në lidhje me aplikimin e kryer pranë ALUIZNI-t Fier.

**1.16.2** Lidhur me vlerën e ndërtimit të kësaj banese, subjekti është shprehur se nuk disponon dokumentacion për të përcaktuar saktësisht vlerën e shpenzuar për ndërtimin informal, shtesat, pasi janë kryer shumë vite më parë, madje edhe disa vite përpara se të merrte detyrën.

**1.16.3** Lidhur me kohën e ndërtimit, subjekti ka parashtruar se dokumenti i depozituar, planshet e vitit 1979, azhurnim i vitit 1987<sup>10</sup>, pasqyrohet qartë se dhoma që ndodhet në pjesën e pasme të banesës është ndërtuar para kësaj kohe. Në këtë kohë (pra vitet 1998 - 1999) ka përfunduar ndërtimi i çatisë. Po ashtu, sipas subjektit, edhe ortofotot e viteve 2004, 2005 dhe 2007 provojnë se banesa ka qenë e ndërtuar/përfunduar dhe në të njëjtën gjendje që është edhe sot, si për sa i përket shtesave anësore, ashtu edhe shtesës në lartësi para vitit 2004, pra para marrjes së detyrës, dhe në këto kushte nuk mund të saktësojë vlerën e shpenzuar, por pavarësisht kësaj, subjekti shprehet se shtesat anësore janë thjesht vetëm dy mure anësore, të cilët të bashkuar me muret e banesës ekzistuese kanë krijuar shtesat anësore. Subjekti ka depozituar edhe një raport vlerësimi nga ekspertë të licencuar, në lidhje me përshkrimin e ndërtesës në tërësi dhe vlerën e investimeve të kryera, ku për shtesat vlera e mundshme e investuar rezulton të jetë në shumën 615.315 lekë dhe sipas preventivit vlera e investimeve të shtesës së katit (papafingo) mbi objektin ekzistues rezulton të jetë në shumën 298.417 lekë. Subjekti pretendon se shpenzimet e kryera për këtë banesë janë në vlerë më të vogël, pasi një pjesë të punimeve i ka kryer vetë bashkëshorti, si dhe se kjo banesë ndodhet në një lagje periferike të qytetit të Fierit (deri para disa kohësh zonë rurale), që do të thotë se shpenzimi nuk mund të jetë në vlerën e llogaritur nga Komisioni.

**1.16.4** Në lidhje me burimin e krijimit të shumës së shpenzuar për ndërtim, subjekti ka parashtruar se kanë shërbyer kursimet familjare të bashkëshortit. Në këtë drejtim, subjekti ka pretenduar se: (i) sipas dokumentacionit<sup>11</sup> që kishte paraqitur për të provuar të ardhurat e saj për periudhën 1996 – 1998, nga Komisioni nuk janë përfshirë të ardhurat për periudhën 15 – 31 dhjetor 1997 dhe muajt janar, prill dhe maj të vitit 1998, duke pretenduar një shumë prej rreth 80.000 lekësh; (ii) bashkëshorti në vitet 1994 - 1995 ka përfutuar të ardhura të siguruara,

<sup>10</sup> Lëshuar nga ASHK-ja, Drejtoria Rajonale Fier.

<sup>11</sup> Vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016.



pasi ka udhëtuar drejt Turqisë me autobusë të agjencive “\*\*\*”, në pronësi të shtetasit A. S., “\*\*\*”, në pronësi të shtetasit H. L., me qendër në Tiranë dhe “T.”; (iii) në mungesë të dokumentacionit provues, pasi siç rezulton nga verifikimet e kryera në Arkivin Shtetëror Vendor Lushnjë, “\*\*\*” sh.a. etj., këto arkiva nuk disponojnë dokumente që datojnë në kohë para 10 vitesh. Duke vlerësuar si prova dokumentacionin e paraqitur, konkretisht deklaratat noteriale të shtetasve E. L. dhe P. B. në lidhje me punët e kryera nga bashkëshorti B. H., subjekti vlerëson se *Komisioni duhet të konkludojë se për të ardhurat e siguruar nga bashkëshorti në këtë periudhë gjendemi përpara kushteve të përcaktuara në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016.*

### **Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm**

**1.17** Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, parashtrimeve, si dhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, arsyeton si vijon:

**1.17.1** Referuar vlerësimin të kësaj pasurie, sa i takon saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaratimeve të subjektit në deklaratën *Vetting*, gjatë hetimit ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka përshkruar qartë të dhënat mbi sipërfaqen, vlerën e shpenzimit të kësaj pasurie, si dhe burimin e krijimit, por i ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, me përshkrimin “*Banesë 1-katëshe e përbërë prej 2 dhomash e një kuzhinë, me sip. 120 m<sup>2</sup>. Nën të njëjtën çati ndodhet edhe dhoma e kunatit tim, i cili ndodhet prej 5 vjetësh në Greqi. Vlera: 3.600.000 lekë. Burimi: e blerë në vitin 1967, kursime familjare*”, e cila ka vlerën e provës sipas ligjit nr. 84/2016.

**1.17.2** Në këtë kontekst, trupi gjykues, moscilësimin e plotë të të dhënave identifikuese të këtij objekti, si dhe çdo të dhënë tjetër, sikurse e kërkon rubrika përkatëse e deklaratës *Vetting*, në raport me shpjegimin se në deklaramin i është referuar gjendjes faktike, e ka çmuar duke bazuar në faktet provuese të renditura në vijim, si dhe në harmoni me çdo të dhënë të dalë gjatë hetimit:

- i) subjekti deklaron në deklaratën *Vetting* se ndërtimi për shtesat anësore është kryer deri në vitet 1998 - 1999 dhe nuk është bërë ndonjë vlerësim i banesës, ndërsa në deklaratën për vitin 2003 e ka deklaruar në mënyrë të plotë;
- ii) kjo pasuri konfirmohet që është blerë nga vjehri i saj, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* regj., datë 31.1.1967, në vlerën 25.000 lekë;
- iii) konfirmohet fakti se bashkëshorti i subjektit ka aplikuar për legalizimin e tyre në datën 2.2.2015, pranë ALUIZNI-t Fier, sikurse subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, procedurë kjo e rezultuar e papërfunduar deri në këtë deklaratë;
- iv) sipas ortofotos së viteve 2004, 2005 dhe 2007 pasuria identifikohet në të njëjtën gjendje (lartësi) që ka edhe aktualisht, pra nuk vërehen investime të tjera;
- v) deklarimi i subjektit gjatë hetimit se *njolla e objektit prej 131,7 m<sup>2</sup> ka rezultuar pas matjeve në terren nga specialistët e ALUIZNI-t dhe është më e madhe nga sa është deklaruar prej saj, pasi në këtë sipërfaqe përfshihet edhe dhoma e kunatit*, përputhet me të dhënat e dokumentuara në praktikën e regjistrimit të kësaj pasurie, ku provohet fakti që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë hequr dorë nga pronësia e dhomës së kunatit;
- vi) nga dokumentacioni i administruar provohet që kjo pasuri është krijuar/investuar në kohën kur subjekti nuk ka qenë në detyrë.

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se ky deklaramin i subjektit nuk është i plotë, në përputhje me kërkesat e formularit të deklarimit, megjithatë, në konsideratë të fakteve të sipërcituara në pikën 1.17.2 (i-vi), çmohet se mosdeklarimi i këtyre të dhënave nuk ka pasur për qëllim mosrespektimin e ligjit për deklarim të saktë dhe të plotë.

**1.17.3** Në lidhje me vlerën e mundshme të investimit në këtë pasuri dhe analizimin e burimeve të tyre, trupi gjykues në këtë çështje vëren se shpjegimet dhe dokumentacioni<sup>12</sup> i depozituar nga subjekti lidhur me përcaktimin e kohës së ndërtimit të shtesave anësore në raport edhe me deklarimin e saj në deklaratë *Vetting*, që shtesat janë ndërtuar deri në vitet 1998 - 1999, janë bindëse, pavarësisht se Komisioni i është referuar çmimeve të Entit Kombëtar të Banesave. Lidhur me këtë të fundit, fakti që planimetria e këtij objekti pasqyron se shtesa dhe çatia janë mbi një objekt ekzistues të blerë që në vitin 1967, ku shtesat janë mure anësore dhe se çatia nuk është një kat i plotë<sup>13</sup>, trupi gjykues nuk mund të arrijë në një konkluzion lidhur me kohën e saktë të ndërtimit, si dhe vlerën reale të shpenzuar për të nga familja e bashkëshortit.

**1.17.4** Trupi gjykues çmon se argumentet e arsyetuar më sipër marrin një vlerë të caktuar edhe në raport me vlerësimin e mundësisë financiare të familjes së bashkëshortit, që të ndërthura me fakte të tjera të qenësishme, si: (i) për sa kohë nuk rezultoi ndonjë e dhënë për kontribut të subjektit në këtë pasuri; (ii) subjekti ka dhënë shpjegime, duke shfaqur përpjekje që vlerësohen si sjellje të bashkëpunimit të saj në këtë proces; (iii) ky investim i familjes së bashkëshortit është kryer kur subjekti nuk ka qenë në detyrë – nuk diktojnë rrethana për penalizimin e saj në pozitën si subjekt rivlerësimi.

**2. Lidhur me pasurinë e deklaruar nga subjekti, automjet tip “Volkswagen”,** me nr. shasie \*\*\*, i regjistruar në DRSHTRR-në Fier, me targa \*\*\*, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar se ky automjet është blerë nga bashkëshorti i saj B. H., sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 28.6.2014, nga shtetasi E. R. A., në vlerën 600.000 lekë. Automjeti është blerë me të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm me targa \*\*\*, shitur shtetasit E. L. Ç., sipas kontratës së shitblerjes nr.\*\*, datë 13.5.2014, në vlerën 500.000 lekë, si dhe të ardhurat nga paga, në përdorim familjar.

**2.1** Nga verifikimet e Komisionit ka rezultuar se subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, me përshkrimin *“Blerje autoveture tip ‘Golf’, me datë 28.6.2014, me kontratën për shitblerjen e automjetit nr. \*\*\*, datë 28.6.2014. Vlera: 600.000 lekë”*. Në këtë deklaratë nuk është deklaruar burimi i krijimit. Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar dokumentacionin mbështetës për këtë pasuri<sup>14</sup>, si vijon:

- Shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016, e DRSHTRR-së Fier. Konfirmohet se në emër të shtetasit B.H.ekziston i regjistruar automjeti tip “Volkswagen”, me targa \*\*\*, me nr. identifikimi \*\*\*. Bashkëlidhur kontrata e shitblerjes së automjetit nr. \*\*\*, datë 28.6.2014, me palë shitëse E.A. dhe palë blerëse B. H.. Vlera: 600.000 lekë. Faturë zhdoganimi datë 1.6.2014.
- Shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\*prot., datë 21.10.2016, nga DRSHTRR Fier. Konfirmohet se automjeti tip “Volkswagen Golf”, me nr. shasie \*\*\* është deklaruar dhe zhdoganuar pranë degës së Doganës Durrës, me deklaratën doganore Imp\*\*\*, datë 1.6.2014, nga shtetasi E. A. . Bashkëlidhur dokumentacioni i deklaratës doganore.
- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2016, e DRSHTRR-së Fier. Vërtetohet se automjeti me targa \*\*\*, me nr. identifikimi \*\*\*, rezulton në pronësi të shtetasit B. H. . Automjeti me targa \*\*\*, i cili vjen nga targa \*\*\*, i blerë me kontratën nr. \*\*\* dhe i shitur me kontratën nr. \*\*\*, datë 13.5.2014. Bashkëlidhur kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 13.5.2014, me palë shitëse B. H.dhe palë blerëse E. Ç., në vlerën 500.000 lekë.

<sup>12</sup> Planshet e vitit 1979 - azhornim \*\*\*, ku pasqyrohet se dhoma që ndodhet në pjesën e pasme të banesës është ndërtuar para kësaj kohe.

<sup>13</sup> Ky investim nuk mund të ketë të njëjtën kosto me një ndërtim të ri që fillon prej themeleve.

<sup>14</sup> Aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

## **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**2.2** DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2020, informon se shtetasi B. D. H. ka pasur të regjistruar në pronësi të tij automjetin me targa \*\*\*.

**2.3** Nga dokumentacioni i administruar nga kjo drejtori rezulton se automjeti është blerë nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 28.6.2014, me palë shitëse E.A. dhe palë blerëse B. H. . Vlera: 600.000 lekë. Ky automjet rezulton të jetë shitur pas depozitimit të deklaratës *Vetting*, me kontratën e shitblerjes nr\*\*\*, datë 8.5.2018, në vlerën 4.500 euro.

Komisioni hetoi për burimin e krijimit të kësaj pasurie.

**2.4** Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burim krijimi për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm, me targa \*\*\*, shitur shtetasit E. L. Ç., sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 13.5.2014, në vlerën 500.000 lekë, si dhe të ardhurat nga paga.

**2.5** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 subjekti e ka deklaruar shitjen e automjetit me përshkrimin “Shitje e autoveturës tip ‘Benz’, me datë 13.5.2014, me kontratën për shitblerjen e automjetit nr. \*\*\*, datë 13.5.2014. Vlera: 500.000 lekë”.

**2.6** Blerja dhe shitja e këtij automjeti konfirmohet edhe nga DPSHTRR-ja. Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se automjeti me targa \*\*\*, i cili është shitur më 13.5.2014, në vlerën 500.000 lekë, është blerë më 8.10.2009, në vlerën 400.000 lekë.

**2.7** Për shkak se automjeti është shitur më shtrenjtë se sa është blerë, Komisioni ka përfshirë në analizë si të ardhur nga shitja vlerën që është shpenzuar për blerjen e tij. Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjetit (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes), për sa kohë nuk është provuar pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar nuk mund të trajtohet si ardhur e ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, kjo vlerë është zbritur nga e ardhura e arkëtuar nga shitja e automjetit.

**2.8** Meqenëse Komisioni e ka të pamundur të identifikojë kohën e saktë të kryerjes së disa shpenzimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj, kreu analizën financiare vjetore dhe jo në momentin e investimit.

**2.9** Pas përllogaritjeve financiare të kryera nga Komisioni, u konstatua se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në vlerën 85.281 lekë për të investuar në blerjen e këtij automjeti, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare, duke i kërkuar shpjegime subjektit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**2.10** Në shpjegimet e saj, subjekti ka parashtruar se diferenca në analizën financiare të Komisionit në shumën prej 85.281 lekësh është rrjedhojë e:

a) Së pari, vjen nga fakti që vlera e shitjes së automjetit nuk është përllogaritur në shumën 500.000 por 400.000 lekë. Sipas subjektit dhe bashkëshortit është vlerësuar se diferenca që rezulton midis çmimit të shitjes së një automjeti dhe çmimit të blerjes nuk është një e ardhur e tatueshme, për shkak se nuk mund të dihet me siguri nëse kjo diferencë është fitim apo jo (për shkak të riparimeve dhe përmirësimeve që mund të kryhen në një automjet). Për këtë deklaramin subjekti ka depozituar shkresën nr. \*\*\*prot., datë 7.7.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

b) Së dyti, analiza e Komisionit kryhet mbi të dhëna statistikore dhe shuma e konstatuar në rastin konkret prej 85.281 lekësh është e vogël dhe brenda një marzhi gabimi të lejuar në përllogaritje (disa zëra shpenzimesh si shkollimi, udhëtimet në një përqindje të caktuar dublohen në analizën financiare). Sipas subjektit janë kushtet e mësipërme që çojnë në

vlerësimin e saj se ajo/bashkëshorti kanë pasur mundësi financiare për blerjen e këtij automjeti, si dhe përballimin e shpenzimeve të tjera familjare gjatë vitit 2014.

### **Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm**

**2.11** Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar në sipër, parashtrimeve dhe provave të depozituara prej saj, arsyeton si vijon:

- Konstatimi fillestar në rezultatet e hetimit nuk ndryshon, pasi Komisioni, në përlllogaritjet e tij, vlerën e të ardhurave nga shitja e automjetit i ka marrë në vlerën 400.000 lekë (shumë kjo e barabartë me vlerën e blerjes së këtij automjeti) për faktin se rezulton se ai është shitur më shtrenjtë se sa është blerë dhe nuk rezulton të jetë paguar tatimi për të ardhurat e përfituara nga shitja. Nga ana tjetër, shkresa nr\*\*\* prot., datë 7.7.2021, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier nuk përputhet me informacionin e disponuar më parë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve<sup>15</sup>, të trajtuara në subjekte të tjerë të rivlerësimit me të njëjtin objekt, si dhe me praktikën e konsoliduar përmes vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>16</sup> dhe, për rrjedhojë, çmon se pretendimi i subjektit nuk qëndron.

- Trupi gjykues, pavarësisht arsytimit të mësipërm, këtë balancë negative, në raport edhe me pretendimin tjetër të subjektit (pika 2.10, germa “b”), e ka vlerësuar nën çmuarjen e faktit se pamjaftueshmëria financiare në vlerën 85.281 lekë, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit të çështjes së rivlerësimit në tërësi, nuk mund të vlerësohet e tillë që të ngrihet në nivelin e ndonjë kualifikimi ligjor për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

### **3. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, e pagës së subjektit si prokurore, me gjendje aktuale në shumën 2.019.676,87 lekë. Pjesa takuese: 100 %<sup>17</sup>.**

**3.1** ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Pasaktësi në deklaratimet ndër vite të likuiditeteve në ‘Raiffeisen Bank’, pasi subjekti në vite të ndryshme nuk ka deklaruar mbylljet e llogarive (destinacionin e tyre), ndryshimet e gjendjeve të tyre ose është mjaftuar me paraqitjen e dokumentit bankar, e padeklaruar në formularin e interesave private”*.

**3.2** Trupi gjykues, nën konstatimin se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr\*\*\* prot., datë 11.5.2020, ka konfirmuar llogarinë rrjedhëse në emër të znj. Elida Hoxhaj, me gjendje në datën 27.1.2017 në shumën 2.019.676,87 lekë dhe ka konkluduar se deklarimi i subjektit është i saktë.

### **4. Llogari rrjedhëse, e pagës së bashkëshortit pranë Bashkisë Fier, me gjendje aktuale në shumën 2.499,45 lekë. Pjesa takuese: 0 %.**

**4.1** Nga hetimi administrativ ka rezultuar se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr\*\*\*prot., datë 11.5.2020, ka konfirmuar llogarinë rrjedhëse në emër të shtetasit B. H., me gjendje në datën 27.1.2017, në shumën 2.499,45 lekë.

**4.2** Trupi gjykues, sipas fakteve të dala më sipër, konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi përputhet me dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”.

### **5. Llogari bankare nr. \*\*\*, në “\*\*\*Bank”<sup>18</sup>, me adresë: San Antonio \*\*\*, New York, e vajzës J. H., me gjendje aktuale në shumën 1.222,64 USD, deklaruar nga subjekti në**

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 10.4.2018, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

<sup>16</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë 2.12.2019, për subjektin E. P., paragrafi 65.4

<sup>17</sup> Referuar dokumentacionit të administruar në ILDKPKI, evidentohen në pasqyrat e nxjerrjes së llogarive në “Raiffeisen Bank”, të datave 7.3.2013, 19.3.2014 dhe 17.3.2015, gjendjet e mbetura të llogarisë rrjedhëse të subjektit (aneks nr. 35).

<sup>18</sup> Nxjerrje llogarie nr. \*\*\*, pranë “\*\*\*Bank”. Balanca fillestare e llogarisë 2.625,93 USD, balanca aktuale 1.223,64 USD. Formular transfertë nga UBA Bank nga shtetasi B.H. e shumës 3.000 USD në favor të shtetasit J.H., datë 25.10.2016; tërheqje

deklaratën *Vetting*. Burimi i krijimit të kësaj pasurie janë kursimet nga paga e subjektit dhe tërhequr nga llogaria rrjedhëse në datën 12.8.2016, për shpenzimet e jetesës së vajzës në SHBA. Pjesa takuese: 0 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>19</sup>.

**5.1** ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: “*Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPPP-ja*”.

**5.2** Subjektit<sup>20</sup> i është kërkuar të depozitohet *statement*-in e llogarisë bankare të vajzës në SHBA.

**5.3** Në dokumentacionin e depozituar vihet re se *statement*-i nuk daton nga momenti/data i/e hapjes, pra është i fragmentizuar dhe nuk identifikohen të gjitha transaksionet e kryera.

**5.4** Sipas dokumentacionit të depozituar, gjendja në datën 8.12.2016 është në vlerën 1.223,64 USD.

**5.5** Subjekti e ka depozituar deklaratën *Vetting* më 27.1.2017 dhe në këtë datë gjendja e llogarisë është në vlerën 389,80 USD.

**5.6** Komisioni, gjatë verifikimeve të dokumentacionit të administruar, konstatoi se nuk identifikoheshin të gjitha transaksionet e kryera në llogarinë e vajzës së subjektit, duke i kaluar barrën e provës për depozitim të dokumentacionit të plotë ku të pasqyroheshin transaksionet në mënyrë kronologjike pa shpërndarje periudhash kohore.

**5.7** Në lidhje me konstatimin e Komisionit për llogarinë nr. \*\*\* në “\*\*\*\*Bank”<sup>21</sup>, të vajzës së saj, subjekti ka parashtruar se e bija ka filluar të jetojë në SHBA nga gushti i vitit 2016 (22.8.2016), kohë kur ka shkuar për të vazhduar studimet. Vajza e saj ka udhëtuar drejt Shqipërisë në datën 19.12.2016, ku ka qëndruar mbi 1 muaj e gjysmë, deri në datën 27.1.2017. Subjekti ka depozituar dokumentacionin, komunikimin elektronik, datë 30.6.2021, nga “\*\*\*\*Bank”, përmes së cilit i është vënë në dispozicion *statement*-i i llogarisë për vitin 2016, duke shpjeguar se nuk kishte pasur mundësi ta siguronte më parë.

Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, arsyeton se subjekti ka provuar me dokumentacion/*statement* të llogarisë së vajzës nga SHBA-ja nga data 25.8.2016 deri më 8.12.2016, ku pasqyroheshin transaksionet në mënyrë kronologjike, dhe në kushtet e moskonstatimit të ndonjë depozitimi përtej shumës së deklaruar nga subjekti për shpenzimet e vajzës në SHBA, që mund të passillte një rivlerësim të situatës financiare, konkludoi se subjekti ka deklaruar saktë llogarinë bankare të vajzës.

**6. Gjendje cash në vlerën 2.000 USD**, mbetur nga shuma e tërhequr nga llogaria rrjedhëse e subjektit, me datë 12.8.2016. Pjesa takuese: 100 %.

**6.1** Subjekti ka deklaruar gjendje *cash* vetëm në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, me përshkrimin: “*2.000 dollarë amerikanë cash, shumë cash e mbetur nga tërheqja e datës 12.8.2016*”.

**6.2** Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka tërhequr në datën 12.8.2016 nga llogaria e saj e pagës në “Raiffeisen Bank”, shumën 1.200.000 lekë, veprim ky i cili është deklaruar prej saj edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016.

---

nga llogaria e “Raiffeisen Bank” e shumës 1.200.000 lekë, datë 12.8.2016, me urdhërues Elida Hoxhaj, me përshkrim veprimi “tërheq për studime për fëmijë të ardhurat nga kursimet familjare”.

<sup>19</sup> Aneks nr. 4 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>20</sup> Me pyetësorin nr. 6, datë 4.6.2021.

<sup>21</sup> Nxjerrje llogarie nr. \*\*\* pranë “\*\*\*\*Bank”. Balanca fillestare e llogarisë: 2.625,93 USD; balanca aktuale: 1.223,64 USD. Formular transfertë nga UBA nga z. B. H. e shumës 3.000 USD në favor të J. H., datë 25.10.2016; tërheqje nga llogaria e “Raiffeisen Bank”, e shumës 1.200.000 lekë, datë 12.8.2016, me urdhërues Elida Hoxhaj, me përshkrim veprimi “Tërheq për studime për fëmijë, të ardhurat nga kursimet familjare”.

**6.3** Pas përllogaritjeve financiare të kryera nga Komisioni, u konstatua se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 491.562 lekë për të përballuar shpenzimet familjare, si dhe të kursente shumën e deklaruar, duke i kaluar barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë argumentet e saj.

**6.4** Në parashtrimet e saj për këtë çështje, subjekti ka kontestuar përllogaritjet e Komisionit, duke pretenduar se shpenzimet e jetesës për vitin 2016 kanë qenë më të ulëta. Konkretisht, subjekti ka kontestuar: (i) shpenzimet për qiranë e banesës, të cilat sipas saj janë me vlerë 350 USD/muaj, pasi qiraja është ndarë me një tjetër vajzë shqiptare, nga muaji shtator deri në dhjetor të vitit 2016, me vlerë të përgjithshme 1.400 USD, por se nuk disponon dokumentacion; (ii) shpenzimet e ushqimit, pasi sipas deklaramit të vajzës (shprehet subjekti) shkojnë rreth 100 USD/muaj, dhe duke bërë një përllogaritje të shpenzimeve të jetesës për këtë periudhë ato janë disa herë më të ulëta nga sa janë përllogaritur nga Komisioni.

Në vijim, subjekti ka parashtruar se vajza e saj ka shkuar në SHBA si studente dhe jo si turist<sup>22</sup>, shpenzimet jetike për këtë periudhë nuk mund të jenë më shumë se 3.000 USD (50 % e shumës si turist).

**6.4.1** Lidhur me burimin e këtyre shpenzimeve, subjekti ka parashtruar se kanë shërbyer të ardhurat nga paga e saj, të tërhequra në datën 12.8.2016, por siç e kishte shpjeguar edhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 5, datë 7.5.2021, duke qenë se banka në momentin e tërheqjes kërkonte arsyen dhe burimin, ka deklaruar se kjo shumë tërhiqet për shkollimin e vajzës, por jo e gjitha ka shkuar për shkollim. Shuma prej 3.000<sup>23</sup> USD, dërguar vajzës nëpërmjet UBA Bank në datën 25.10.2016 dhe shuma prej 2.000 USD, e deklaruar si gjendje *cash*, sipas subjektit janë pjesë e shumës së tërhequr në “Raiffeisen Bank” në datën 12.8.2016.

**6.4.2** Gjithashtu, subjekti ka paraqitur një analizë financiare sipas përllogaritjeve të saj, pa analizuar çdo pikë të analizës së Komisionit, por duke ndryshuar vetëm shpenzimet për jetesë të vajzës së saj, që sipas saj rezultojnë që në vitin 2016 e bija ka pasur mundësi financiare për të përballuar shpenzimet familjare, si dhe të kursente shumën e deklaruar.

**6.5** Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, parashtrimeve, si dhe provave të administruara, arsyeton si vijon:

**6.5.1** Lidhur me pretendimin e subjektit se nga shuma e tërhequr prej 1.200.000 lekësh për shpenzimet e vajzës në SHBA, 2.000 USD i dispononte gjendje *cash*, trupi gjykues, gjatë verifikimeve të lëvizjeve bankare në UBA Bank, konstaton se në këtë llogari ka derdhje në shumën 3.000<sup>24</sup> USD në datën 25.10.2016 dhe shuma 2.000 USD është gjendje *cash* e deklaruar nga subjekti, që në tërësi përputhet me deklaramin e saj se derdhja e shumës 3.000 USD dhe 2.000 USD si gjendje *cash* janë pjesë e shumës së tërhequr në “Raiffeisen Bank” në datën 12.8.2016. Ky konkluzion arrihet edhe në kushtet se nga hetimi ka rezultuar se në vitin 2016 subjekti ka deklaruar llogari bankare të vajzës në SHBA, e cila rezultojnë të jetë hapur me të ardhurat e saj. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se shumës së përllogaritur për shpenzimet e vajzës duhet t’i zbritet gjendja e likuiditeteve në bankë prej 1.223,64 USD, kjo për faktin se burimi i kësaj llogarie, si dhe shpenzimeve të tjera të jetesës së vajzës në SHBA është pikërisht tërheqja prej 1.200.000 lekësh në “Raiffeisen Bank”, e kryer prej subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, rezultojnë se shpenzimet e jetesës në SHBA nga 943.420 lekë, pas rrllogaritjeve

<sup>22</sup> Subjekti referon vendimin nr. 11, datë 22.5.2019, të KPA-së, duke deklaruar se edhe sikur vajza e saj të kishte shkuar si turistë në SHBA vlera e shpenzuar prej saj nuk do ishte më shumë se 6.000 USD, për një periudhë katër mujore

<sup>23</sup> Një pjesë e kësaj shume është përllogaritur nga Komisioni si shtesë likuiditeti në llogarinë e vajzës në fund të vitit.

<sup>24</sup> Një pjesë e kësaj shume është përllogaritur nga Komisioni si shtesë likuiditeti në llogarinë e vajzës në fund të vitit.

shkojnë në shumën 786.439 lekë. Si pasojë e këtij vlerësimi, rezulton se balanca negative pas këtij ndryshimi, nga 491.562 lekë është në shumën 334.581 lekë.

**6.5.2** Lidhur me pretendimin e subjektit se shpenzimet e jetesës për vitin 2016 të vajzës së saj janë më të ulëta, pasi janë ndarë me një vajzë tjetër shqiptare, trupi gjykues çmon se ky kërkim/prendim ka mbetur vetëm në kuadër deklarativ dhe, për rrjedhojë, nuk ka impakt në balancën negative.

Në përfundim nga përlogaritjet e kryera, duke konsideruar siç u vlerësua më sipër për secilin pretendim, rezultoi se subjekti ndodhet në balancë negative në shumën 334.581 lekë, për të cilën trupi gjykues, në raport me vlerësimin tërësor të procesit të kontrollit të pasurisë, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, çmon se ky rezultat nuk është i mjaftueshëm për aplikimin e ndonjë mase disiplinore, në kuptim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

## **7. Në deklaratën *Vetting* është plotësuar edhe deklarimi i personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, i cili ka deklaruar pasuritë, si vijon:**

**7.1** Shtëpi banimi, në zotërim, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, blerë nga babai i bashkëshortit të subjektit sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* regj., datë 31.1.1967, në vlerën 25.000 lekë. Që nga kjo kohë e në vijim, deri në vitet 1998 - 1999, bashkë me prindërit e vëllezërit që kanë jetuar në këtë shtëpi për nevoja familjare, janë bërë shtesa anësore, për të cilat ka aplikuar pranë ALUIZNI-t Fier për legalizimin e tyre në datën 2.2.2015 (e paregjistruar). Sipas deklarimit të bashkëshortit të subjektit, nuk është bërë ndonjë vlerësim i shtëpisë, pasi është e paregjistruar. Pasuri trashëgimore, e pandarë.

**7.2** Automjet tip “Volkswagen”, me targa \*\*\*, me nr. shasie \*\*\*, i regjistruar në DRSHTRR-në Fier, blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 28.6.2014, nga shtetasi E. R. A., në vlerën 600.000 lekë. Automjeti është blerë me të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm me targa \*\*\*, shitur shtetasit E. L. Ç., sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 13.5.2014, në vlerën 500.000 lekë, si dhe të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100 %.

**7.3** Llogari rrjedhëse nga paga si elektrikist në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike në Bashkinë Fier. Gjendja aktuale e llogarisë: 2.499,45 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Trupi gjykues, pas konstatimeve se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të njëjtat pasuri si subjekti i rivlerësimit, të cilat janë trajtuar/arsyetuar në pikat (nr. 1-6) më sipër, vlerëson të mos bjerë në përsëritje, pasi referohen të njëjtat fakte, vlerësime arsyetime dhe konkludime.

**8.** Në deklaratën *Vetting* është plotësuar edhe deklarimi i vajzës së subjektit të rivlerësimit, J. H., lidhur me llogarinë debit në emër të saj, me nr\*\*\*\*, në “\*\*\*\*Bank”, e çelur në vitin 2016, me adresë: San Antonio \*\*\*, New York. Gjendja aktuale e llogarisë: 1.222,64 USD. Vajza e subjektit ka deklaruar: “*Burimi i krijimit të kësaj llogarie janë kursimet nga paga e nënës time dhe tërhequr nga llogaria rrjedhëse e saj me datë 12.8.2016 për shpenzimet e jetesës. Pjesa takuese: 100 %*”.

Trupi gjykues, edhe për këtë llogari bankare të vajzës së subjektit, pas konstatimit se është e njëjtë më atë të deklaruar edhe nga subjekti i rivlerësimit, e cila është trajtuar/arsyetuar në pikën 5 të këtij vendimi, çmon gjithashtu të mos bjerë në përsëritje.

**9. Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi disa gjetje të tjera,** dhe konkretisht i rezultoi se subjekti rivlerësimit ka investuar në blerjen e dy automjeteve, përkatësisht në vitet 2006 dhe 2009. Këto automjete janë shitur dhe subjekti nuk i disponon dhe, për pasojë, nuk i ka deklaruar

në deklaratën *Vetting*. Blerja e tyre është deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike përkatëse, si vijon:

- automjet tip “Benz 250”, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 5.4.2006, ende e paregjistruar në emër të bashkëshortit në DRSHTRR-në Fier;
- blerje automjeti me targa \*\*\*, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 8.10.2009. Vlera: 400.000 lekë.

**9.1** DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2020, dhe dokumentacionin e përcjellë, konfirmon blerjen dhe shitjen e këtyre automjeteve.

**9.2** Subjekti është pyetur për burimin e krijimit të secilit automjet. Për automjetin<sup>25</sup> e blerë në vitin 2006, në shumën 250.000 lekë, burim krijimi kanë shërbyer kursimet nga pagat.

**9.3** Nga analizimi i dokumentacionit dhe analizës financiare të kryer, Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika për këtë automjet.

**9.4** Ndërsa për automjetin e blerë në datën 8.10.2009, me targa \*\*\*, në shumën 400.000 lekë, burim krijimi sipas deklaramit të subjektit<sup>26</sup> kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Benz”, me targa \*\*\*, si dhe kursimet familjare.

**9.5** Gjatë hetimit ka rezultuar se automjeti me targa \*\*\*, i cili ka shërbyer si burim krijimi është shitur në datën 23.1.2009, në vlerën 250.000 lekë.

Në kontratën e shitjes së automjetit nr. \*\*\*, datë 8.10.2009, me palë shitëse K. B. Y. dhe palë blerëse B. D. H., citohet se palët janë likuiduar plotësisht dhe se nuk kanë detyrime ndaj njëra-tjetrës.

**9.6** Sipas hetimit të pasqyruar në pikën 2.6, ky automjet është shitur në vitin 2014, pra pas 5 vitesh, në vlerën 500.000 lekë, nga 400.000 lekë që është blerë. Ndërsa automjeti i analizuar në pikën 2.3 rezulton të jetë shitur në vlerën 4.500 euro në vitin 2018, pra pas 4 vitesh nga blerja, në vlerën 600.000 lekë.

**9.7** Komisioni kreu analizën financiare në momentin e investimit për automjetin e blerë në tetor të vitit 2009.

**9.8** Pas përlllogaritjeve financiare të kryera nga Komisioni u konstatua se dukej se subjekti: (i) nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 490.807 lekë për të investuar në blerjen e këtij automjeti, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; (ii) dukej se automjeti i blerë në vitin 2009 ishte shitur në vitin 2014 më shtrenjtë se sa ishte blerë, duke i kërkuar shpjegime subjektit për të dhënë argumentet e saj, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

## **9.9 Subjekti, në qëndrimin e saj mbi konstatimet e Komisionit, ka parashtuar:**

**9.9.1** Automjeti me targa \*\*\* është blerë nga shtetasi K. Y. me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 8.10.2009, në shumën 400.000 lekë. Shtetasi K. Y. ka qenë banor i qytetit të Fierit dhe prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në vitin 1993 dhe ka pasur njohje familjare me të, pavarësisht se në kontratën e shitblerjes së automjetit është pasqyruar se palët janë likuiduar plotësisht dhe se nuk kanë detyrime ndaj njëra-tjetrës. Duke qenë se kanë pasur njohje me shitësin dhe në marrëdhënie mirëbesimi kanë rënë dakord që shumën prej 400.000 lekësh për blerjen e automjetit do ia jepnin pak kohë më vonë, duke përdorur për këtë qëllim një shumë të depozituar prej 400.000 lekësh, për të mos prekur interesat. Këtë shumë ia kishin dhënë shtetasit K. Y. në nëntor të vitit 2009, kur është tërhequr nga llogaria e saj në

---

<sup>25</sup> Pyetësor nr. 2, datë 1.4.2021.

<sup>26</sup> Pyetësor nr. 5, datë 7.5.2021.



shumën 400.000 lekë për këtë qëllim. Subjekti ka depozituar edhe *statement*-in e llogarisë së saj në nëntor të vitit 2009.

**9.9.2** Në lidhje me konstatimin e Komisionit se automjeti i blerë në vitin 2009 është shitur në vitin 2014 më shtrenjtë nga sa është blerë, subjekti ka shpjeguar se për shkak se gjatë përdorimit automjetit i janë kryer edhe shërbime, por edhe për faktin se vlera e tregut ka ndryshuar, është shitur 100.000 lekë më shtrenjtë nga sa është blerë.

**9.10** Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, nën vlerësimin e fakteve dhe provave në raport me shpjegimet e subjektit, arsyeton se pretendimet e saj nuk mund të merren në konsideratë, pasi: (i) palët kanë deklaruar para noterit se çmimi është likuiduar; (ii) në tërësi të fakteve, deklarimi i subjektit se kjo pagesë është kryer në nëntor të vitit 2009, Komisioni konstaton se kjo tërheqje nuk ka përshkrimin për blerje automjeti, por për shpenzime të tjera; (iii) në përlllogaritje financiare, Komisioni i qëndron çmimit të blerjes së këtij automjeti, për sa kohë rezultojnë se nuk është paguar tatimi i të ardhurës si fitim prej diferencës ndërmjet çmimit të shitjes me atë të blerjes, rrethanë kjo, që, e vlerësuar edhe në harmoni me faktin se pretendimet për kryerjen e shërbimeve të tjera për automjetin mbetën në nivel deklarativ, trupi gjykues çmon se konstatimet e Komisionit në rezultatet e hetimit nuk ndryshojnë.

Pavarësisht sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues, çështjen në lidhje me balancën negative në shumën 490.807 lekë, e ka çmuar në raport me vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit, që në zbatim të parimit të proporcionalitetit çmon se nuk është e mjaftueshme për aplikimin e ndonjë mase disiplinore, në kuptim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**10.** Po ashtu, në kuadër të hetimit shterues administrativ, Komisioni, nga korrespondenca e mbajtur me RNSH-në, i rezultuan tri kontrata noteriale, ku si palë identifikohet subjekti i rivlerësimit, por edhe familjarët e saj të origjinës.

Në të tilla kushte subjektit i është kërkuar<sup>27</sup> depozitimi i kontratave noteriale.

**10.1.** Në lidhje me verifikimin e kontratës nr. \*\*\*, datë 18.11.2016, për shitblerje pasuri të paluajtshme:

**10.1.i** Komisionit, nga verifikimi i kontratës nr.\*\*\*, datë 18.11.2016, për shitblerje pasuri të paluajtshme, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit, si palë shitëse, së bashku me shtetasit H., L. dhe N. Ç., të cilët identifikohen në marrëdhënie prindër - fëmijë, i kanë shitur shtetasit H. K. një apartament banimi me sip. 86,81 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, e regjistruar në vol. \*\*\*, f. \*\*\*, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, në shumën 4.500.000 lekë. Nga dokumentacioni bashkëlidhur kontratës konstatohet se 4 bashkëpronarët e lartpërmendur kanë pasur në pronësi këtë pasuri, sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar nga ZVRPP-ja Fier, në datën 27.2.2012.

Sipas të dhënave të përshkruara në kontratën e shitjes, duket se apartamenti ka qenë përfituar me privatizim.

**10.1.ii** Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore nuk rezultojnë që subjekti të ketë deklaruar pasuri në bashkëpronësi, shitje të saj dhe as të ardhura të krijuara prej kësaj të fundit. Në të tilla kushte, subjektit i është kërkuar<sup>28</sup> të japë shpjegime lidhur me këto konstatime.

**10.1.iii** Në përgjigjen e dhënë, subjekti ka shpjeguar se këtë banesë nuk e ka konsideruar asnjëherë si pasuri të saj dhe për këtë arsye nuk e ka deklaruar ekzistencën e saj. Ajo ka sqaruar se kjo pasuri është regjistruar me privatizim nga EKB-ja me kontratën e privatizimit lidhur ndërmjet babait të saj H. Ç. dhe EKB-së, në datën 19.8.1993. Subjekti ka deklaruar se në këtë

<sup>27</sup> Me pyetësin nr. 5, datë 25.5.2021.

<sup>28</sup> Me pyetësin nr. 6, datë 4.6.2021.

banesë kanë jetuar prindërit e saj së bashku me vëllanë, bashkëshorten e tij dhe fëmijët, ndërsa ajo është martuar në vitin 1996. Subjekti ka deklaruar se nga shitja e kësaj pasurie nuk ka përfituar asnjë shumë, si dhe nuk ka kryer asnjë pagesë lidhur me tatimin mbi të ardhurat e përfituara. Subjekti ka deklaruar se duke qenë se nuk ka pasur asnjë përfitim nga shitja e apartamentit me nr. pasurie \*\*\*, mosdeklarimi i shitjes ka qenë një harresë nga ana e saj. Ajo ka depozituar dokumentacionin mbi fitimin e kësaj pasurie, nga i cili konstatohet se është përfituar nga Ndërmarrje Komunale Banesa me privatizim.

**10.2** Komisioni, nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar shitëse në pjesë takuese të kësaj pasurie, i kërkoi shpjegime, pasi dukej se nuk kishte deklaruar zotërimin e pjesës takuese në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 (prej momentit që është bërë subjekt deklarimi) dhe as shitjen e apartamentit në deklaratën për vitin 2016.

**10.3** Mbi këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka parashtruar se nisur nga fakti se është martuar që në vitin 1996, nuk e ka konsideruar asnjëherë si pasurinë e saj shtëpinë e prindërve, në të cilën këta të fundit kanë jetuar dhe jetojnë e aktualisht me familjen e vëllait. Subjekti ka deklaruar se vëllai dhe bashkëshortja e tij edhe aktualisht jetojnë bashkë dhe kujdesen për prindërit e saj të moshuar. Sipas vërtetimit datë 17.10.2016, të ZVRPP-së Fier, nuk rezulton të ketë pasuri të regjistruar. Në vijim, ka parashtruar se sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 18.11.2016 (dërguar në përgjigje të pyetësorit nr. 5, datë 25.5.2021) pasuria është shitur dhe sipas certifikatës së pronësisë ku figuronte bashkëpronare ka nënshkruar për shitjen e pasurisë, por duke qenë se nuk kishte përfituar asnjë shumë nga shitja e saj nuk ka kryer deklarimin e shitjes së saj.

Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, arsyeton se subjekti, në bazë të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, ka pasur detyrimin të deklaronte të drejtat reale/bashkëpronësinë e kësaj pasurie, si dhe më pas shitjen e saj. Trupi gjykues, nisur nga fakti se në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* kjo pasuri është shitur dhe se këto të ardhura në asnjë moment të hetimit nuk janë deklaruar si burim krijimi, për ndonjë pasuri apo shpenzime të tjera, çmon se jemi përpara një deklarimi të pasaktë në deklaratat periodike, pasaktësi që nuk mund të ngrihen në nivelin e ndonjë shkakut për penalizimin e saj.

**10.4** Komisioni, po nga korrespondenca e mbajtur me RNSH-në, verifikoi edhe kontratën noteriale nr. \*\*\*, datë 29.7.2013, të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme.

**10.4.i** Nga verifikimi i kësaj kontrate nr. \*\*\*, datë 29.7.2013, të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 58 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në lagjen “\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Fier, rezultoi se shtetasit J. S. N. dhe P. L. N., me cilësinë e palës shitëse, përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. \*\*\*, datë 10.1.2011, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit B.H., i kanë shitur shtetasen V. D. Q. (motrës së bashkëshortit të subjektit) apartamentin në shumën 2.000.000 lekë.

**10.4.ii** Në prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 10.1.2011, shitësit e pasurisë citojnë se kanë marrë nga përfaqësuesi (pra, nga bashkëshorti i subjektit) në datën e nënshkrimit të prokurës (10.1.2011), shumën 2.000.000 lekë, që përbën vlerën e apartamentit të shitur, e cila është dhënë në rrugë bankare pranë NBG Bank, dega Fier.

Nga dokumenti bankar i administruar<sup>29</sup>, në llogarinë bankare të shtetasit J. N. nuk identifikohet transferimi i shumës 2.000.000 lekë nga shtetasi B. H., me përshkrimin përkatës sipas prokurës së posaçme.

Ndërkohë, ABI Bank<sup>30</sup> (ish-NBG) nuk konfirmon që subjekti i rivlerësimit apo bashkëshorti i saj të jenë klientë të bankës.

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 16.6.2021, e ABI Bank.

<sup>30</sup> Shkresë nr.\*\*\*prot., datë 4.5.2021.

Po ashtu, në prokurë cilësohet se të përfaqësuarit i kanë dhënë të drejtë bashkëshortit të subjektit: (i) të shesë pasurinë e tyre tek çdo i tretë pa kufizim në të drejta dhe kohë; (ii) sipas vlerësimit të tij të bëjë kalimin në pronësi të tij të kësaj pasurie dhe të nënshkruajë kontratën noteriale për këtë qëllim; dhe se (iii) përfaqësuesi mund të ushtrojë çdo të drejtë që buron nga pozita e tyre e bashkëpronarit në këtë pronë, deri në tjetërsimin përfundimtar të saj në çdo formë dhe në çdo të tretë, apo dhe në emrin e tij si B. H., në çdo kohë.

**10.4.iii** Rezultoi se kontrata e shitjes për këtë pasuri ishte formalizuar në datën 29.7.2013, mes përfaqësuesit me prokurë të posaçme (bashkëshorti i subjektit) të shtetasve J. S.N. dhe P. L. N. (si shitës) dhe shtetasen V. Q.(si blerëse), motra e bashkëshortit të subjektit.

**10.4.iv** Subjektit i është kërkuar<sup>31</sup> të depozitojë aktin e regjistrimit të pasurisë në emër të blerëses V. D. Q. . Subjekti ka depozituar certifikatën përkatëse dhe kartelën e pasurisë, nga verifikimi i të cilave konstatohet se pasuria është regjistruar në emër të shtetasen V.Q. .

**10.4.v** Subjekti, e pyetur<sup>32</sup> në lidhje me përmbajtjen e prokurës, ka deklaruar se: *“[...] në dijeninë time motra e bashkëshortit V. Q. ka kryer transferimin e shumës prej 2.000.000 lekësh pjesë-pjesë, në formë cash, në udhëtimet që ka bërë drejt Shqipërisë. Ajo ka hyrje-dalje në territorin e Republikës së Shqipërisë, por ka qenë në pamundësi për të ardhur në Shqipëri në vitin 2011, kohë kur shitësit ndodheshin në Shqipëri. Shuma e sjellë pjesë-pjesë prej saj është ruajtur prej nënës së V., D. H. . Për sa i përket transferimit të shumës shitësve, sqaroj se transferata është kryer në rrugë bankare, nëpërmjet NBG Bank, dega Fier (aktualisht e bashkuar me ABI Bank), e përmendur edhe në prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 10.1.2011. Motra e bashkëshortit prej vitit 1992 jeton në Greqi. Në vitin 2011 ka qenë e interesuar për blerjen e një shtëpie në qytetin e Fierit dhe ka rënë në dijeni se shtetasi J. N. ishte pronar i një shtëpie me sip. 58 m<sup>2</sup>, të cilën donte ta shiste. Shtetasi N., po ashtu jetonte familjarisht në Greqi dhe se V. nuk mund të vinte në Shqipëri në kohën që shitësi ndodhej në Shqipëri [...], për këtë arsye ka lëshuar një prokurë të posaçme. Kontrata e shitblerjes së shtëpisë është formalizuar në vitin 2013, kohë kur V. ka pasur mundësi për të ardhur në Shqipëri”.*

**10.4.vi** Komisioni aksesoi në sistemin TIMS për të verifikuar mbi ardhjen e shtetasve J. S. N. dhe P. L. N., të cilët në datën 10.1.2011 rezultojnë të kenë lëshuar një prokurë të posaçme përfaqësimi nga bashkëshorti i subjektit, si dhe për shtetasen V. Q. në datën e nënshkrimit prej saj, 29.7.2013, të kontratës së shitjes së pasurisë.

**10.4.vii** Nga verifikimet rezultoi se shtetasit J. S. N. dhe P. L. N. kanë dalë nga Shqipëria në datën 11.01.2011, çka tregon se kanë qenë në territorin shqiptar në datën e nënshkrimit të prokurës.

**10.4.viii** Shtetasja V. Q. ka dalë nga pika kufitare e Kakavijës në datën 23.7.2013 dhe ka hyrë pas 2 viteve, në datën 6.9.2015, çka tregon se nuk ka qenë në territorin shqiptar në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë, 29.7.2013.

**10.5** Subjekti, e pyetur në lidhje me përdorimin e kësaj pasurie, ka deklaruar se: *“[...] nuk kam dijeni nga kush është përdorur ky apartament nga viti 2011 deri në datën e shitjes [...]. Apartamenti në pronësi të motrës së bashkëshortit, V. Q. është shitur sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 11.4.2017. Bashkëshorti im ka nënshkruar kontratën e mësipërme, me cilësinë e përfaqësuesit të motrës së tij, sipas prokurës së posaçme nr. \*\*\*, datë 22.7.2013”.*

**10.6** Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së apartamentit nr. \*\*\*, datë 11.4.2017, si dhe dokumentacionin shoqërues, së bashku me prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 22.7.2013.

<sup>31</sup> Me pyetësin nr. 6, datë 4.6.2021.

<sup>32</sup> Me pyetësin nr. 6, datë 4.6.2021.

**10.7** Në analizë të dokumentacionit të depozituar rezultoi se prokura e lëshuar nga motra e bashkëshortit të subjektit mban datën 22.7.2013. Në prokurë, bashkëshortit të subjektit i jepet e drejta nga shtetasja V. Q. (e motra) për të shitur pasurinë e lartpërmendur, në një kohë që nuk ishte bërë ende pronare e saj, pasi kontrata e shitjes daton më 29.7.2013.

**10.8** Në kontratë, në nenin 4 të saj, citohet se *çmimi i shitjes është transferuar në llogarinë bankare të noteres pranë “Credins Bank”, dokument që në fotokopje do t’i bashkëngjitet kontratës para depozitimit të saj në ZVRPP-në Fier, të cilat do të transferohen në emër të përfaqësuesit të shitëses, z. B. H., me lëshimin e certifikatës së pronësisë në emër të blerëses.*

**10.9** Në vijim, rezultoi se në datën 10.5.2017, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në “Credins Bank” është kryer transferimi i shumës 22.000 euro nga noterja “V. D.”, person fizik, me përshkrimin “kalim sipas kontratës së shitblerjes nr\*\*\*”. Kjo shumë rezulton të jetë tërhequr nga bashkëshorti i subjektit 1 (një) ditë më vonë, në datën 11.5.2017.

**10.10** Komisioni, në analizë të fakteve të dala dhe thelbësisht për faktin se prokura e posaçme datë 22.7.2013 është nënshkruar përpara lidhjes së kontratës së shitjes, datë 29.7.2013, pra pa qenë shitësjja ende titullare e pasurisë, i kërkoi shpjegime subjektit, pasi dukej e paqartë dhënia e prokurës nga shtetasja Q. përfaqësuesit (vëllait) për të shitur një pasuri të cilën ende nuk e kishte blerë.

**10.11** Në lidhje me konstatimin e Komisionit, subjekti ka shpjeguar se: *“Vlera e blerjes së banesës është depozituar për llogari të shtetasve J. e P.N. nga shtetasi D. S., lidhje shoqërore e familjare e bashkëshortit tim. Shuma është depozituar pikërisht ditën e prokurës së posaçme, datë 10.1.2011. Në lidhje me këtë transfertë, me kërkesën datë 29.6.2021 kam kërkuar informacion pranë ABI Bank (e bashkuar NBG Bank), por sipas shkresës datë 2.7.2021 banka nuk mund të ma japë informacionin e kërkuar”.*

**10.11.i** Nga aktet e ndodhura në dosjen e Komisionit, konkretisht nga informacioni i dërguar nga ABI Bank, rezulton kalimi i shumës në llogarinë e shtetasit J.N. në datën 10.1.2011, e cila i korrespondon vlerës së apartamentit të blerë nga shtetasja V. Q. . Subjekti ka depozituar shkresën datë 2.7.2021, të ABI Bank.

**10.11.ii** Shuma që ka shërbyer për blerjen e apartamentit nga motra e bashkëshortit V. Q. është sjellë prej saj dhe i është lënë në mirëbesim nënës së saj (dhe të bashkëshortit). Bashkëlidhur deklarata më shkrim dore, datë 16 dhe 17.5.2021, të shtetasës V. Q., dërguar prej saj me shërbimin postar.

**10.11.iii** Motra e bashkëshortit të subjektit V. Q. ka udhëtuar drejt Shqipërisë në datat 21.7.2013 - 23.7.2013, pra ka qëndruar vetëm 3 ditë. Për të realizuar kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme duhet të paraqitet certifikata e pronësisë, e rifreskuar. Duke qenë se koha e qëndrimit të shtetasës V. Q. në Shqipëri ishte shumë e shkurtër (fundjavë) ajo ka lëshuar prokurën e posaçme datë 22.7.2013, duke autorizuar të vëllanë (bashkëshortin e subjektit B. H.) të kryente veprimet përkatëse, me qëllimin kalimin e pronësisë së banesës në emrin e saj.

**10.11.iv** Sipas subjektit rezultonte i vërtetë fakti se motra e bashkëshortit, në çastin e lëshimit të prokurës, ende nuk ishte titullare e pasurisë, por në atë kohë e kishte paguar vlerën e banesës. Fakti që shitësit J. dhe P. N. kishin lëshuar prokurën e posaçme të parevokueshme për asnjë arsye, duke caktuar si përfaqësues në mirëbesim të të dy palëve shtetasin B.H., ishin garancia që shtetasja V. Q. e kishte blerë banesën dhe kontrata e shitblerjes mbetej thjesht formalizimi i blerjes së saj.

**10.11.v** Më tej, subjekti ka parashtruar se sipas kontratës së shitblerjes dhe aktet bashkëlidhur, certifikata e pronësisë është lëshuar në datën 26.7.2013. Shtetasja V. Q. e ka nënshkruar vetë kontratën e shitblerjes para noterit dhe regjistrimi i saj duhet të jetë bërë më pas, pasi është

siguruar edhe certifikata e pronësisë, e rifreskuar. Pikërisht për këto arsye, shtetasja V. Q. ka lëshuar edhe prokurën e posaçme, pasi hyrje-daljet e saj në Shqipëri, për shkak edhe të gjendjes së saj familjare, janë të rralla dhe në periudha të shkurtra kohore. Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti ka depozituar kontratën noteriale të shtetasës V. Q., duke sqaruar se me shkrim dore është pasqyruar edhe data e certifikatës për vërtetim pronësie, 26.7.2013, si dhe data e kontratës, 29.7.2013.

**10.12** Trupi gjykues, në lidhje me këtë çështje, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë dhe parashtrimeve, arsyeton se veprimet e ndërmarra nga bashkëshorti i subjektit për këtë pasuri nën tagrat e dhëna përmes prokurës/ve së/të lëshuar/a para noterit për llogari të motrës së tij, nuk janë në kundërshtim me ligjin. Trupi gjykues, në prokurën nr. \*\*\*, datë 10.1.2011, konstaton se përveç tagrit të përfaqësimit, rezultojnë edhe pagesa e çmimit për llogari të shitësve, konstatim ky i cili përputhet edhe me parashikimin kontraktual në kontratën datë 29.7.2013, mbi pagesën e çmimit, specifikisht në nenin 3, ku citohet se: “[...] çmimi i rënë dakord nga palët është paguar nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale sipas deklaratimit të palëve”, duke i çmuar bindëse edhe shpjegimet e subjektit.

Nën këtë analizë, trupi gjykues çmon se paqartësitë mbi formalizimin e transaksioneve të kësaj pasurie nuk identifikojnë fakte apo elemente të qenësishme që mund të lidhin subjektin e rivlerësimit apo personin e lidhur me të me këtë pasuri, për të cilën roli i këtij të fundit është përcaktuar në aktet e përfaqësimit para noterit publik në kohë reale, duke arritur në këtë mënyrë në konkluzionin se nuk ka rrethana për penalizimin e subjektit të rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Në përfundim lidhur me vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues vlerëson se pamjaftueshmëria që rezultojnë nga analiza financiare nuk është e një niveli të tillë që të sjellë lindjen e dyshimeve për veprime që cenojnë figurën e prokurorit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elida Hoxhaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit raportin mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\*, datë 2.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.10.2020, të KDZH-së, ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Elida Hoxhaj”.

Trupi gjykues, në kushtet që pas përditësimit të informacionit<sup>33</sup> për subjektin e rivlerësimit, si dhe gjatë hetimit administrativ: (i) nuk evidentoi asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës; (ii) nuk rezultuan të dhëna të tjera që të evidentonin se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara, konkludon se

<sup>33</sup> Me shkresën nr. \*\*\*prot, datë 16.04.2021

subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, duke arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Raporti i vlerësimit profesional është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- d) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; 5 dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënave nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme; si dhe të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

### ➤ **Analiza e gjetjeve**

#### **1. Aftësitë profesionale**

##### *a) Njohuritë ligjore*

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurorja Elida Hoxhaj, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Kështu, pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurore Elida Hoxhaj, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm, për vitet 2012 - 2016, rezulton se për aftësitë profesionale, në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

##### *b) Arsyetimi ligjor*

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga prokurori dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit Elida Hoxhaj shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Ajo tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej saj të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se kryen analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e saj logjik mbi zgjidhjen ligjore.

#### **2. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

##### *a) Etika në punë*

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

*b) Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Elida Hoxhaj dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

*c) Paanësia*

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga 5 dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurore Elida Hoxhaj. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

### **3. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

*a) Aftësitë e komunikimit*

Nga 3 dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

*b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

*c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, rezultojnë se subjekti Elida Hoxhaj ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

#### **➤ Të dhënat arkivore lidhur me masa disiplinore**

Nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezultojnë se prokurorja Elida Hoxhaj nuk ka pasur masa disiplinore. Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës të subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.

## **C/1. RIVLERËSIMI PROFESIONAL**

**a.** Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLP-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, përgjithësisht sa i përket tri<sup>34</sup> dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti<sup>35</sup>, nuk vërejtë problematika të natyrës procedurale, si p.sh., në zvarritjen e

<sup>34</sup> Konkluzione përfundimtare në lidhje me çështjen penale nr. \*\*\*, në ngarkim të të pandehurit Sh. S.; konkluzione përfundimtare në lidhje me çështjen penale nr. \*\*\*, në ngarkim të të pandehurve A. G., etj.; konkluzione përfundimtare në lidhje me kërkesën për ekstradimin për jashtë shtetit të shtetasit V. Z. (A. G.).

<sup>35</sup> **Dosja 1** – kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 23.12.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Dokumenti ligjor – vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, për kallëzimin penal nr. \*\*\*, mosfilluar në datën 24.1.2015. Nga shkresa nr. \*\*\*prot., datë 9.3.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezultojnë se lidhur me këtë kallëzim penal nuk ka asnjë vendim gjyqësor. **Dosja 2** – procedimi penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 27.12.2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Dokumenti ligjor – vendim “Për pushimin e procedimit penal”, datë për procedimin

hetimeve, në përfundimin e çështjeve deri edhe në gjyqësor, nga ku u konstatua se vlerësimi i gjykatës ka qenë në të njëjtën linjë me kërkimin e organit të akuzës mbi provueshmërinë e kryerjes së veprës penale, si dhe me masën e dënimit të kërkuar.

**b.** Raporti i vlerësimit profesional në të dhënat arkivore lidhur me ankesat ka pasqyruar një kallëzim ndaj subjektit të rivlerësimit, të trajtuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dy kallëzime të trajtuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Komisioni, pas analizimit të tyre, vlerësoi t'i kërkojë subjektit të rivlerësimit shpjegime dhe dokumentacion provues mbi çështjet e trajtuara prej saj, të cilat, më tej, nën pretendime të kallëzuesve, janë bërë edhe shkak për depozitim të kallëzimeve ndaj saj. Në vijim jepen të dhëna dhe pretendime të kallëzuesve mbi kallëzimet e depozituara, si dhe kërkimet e Komisionit për subjektin. Më konkretisht:

**b/1.** Mbi bazën e kërkesës për informacion, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2021, ka bërë me dije se ndaj subjektit të rivlerësimit Elida Hoxhaj, prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Fier, është regjistruar kallëzimi penal me nr\*\*\*, i vitit 2020.

**i.** Në datën 15.12.2020 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, mbi bazën e kallëzimit të kryer nga shtetasit F. dhe Xh. K. . Kallëzuesit pretendojnë se prokurorja Elida Hoxhaj, e cila drejton hetimet në një procedim të regjistruar për veprën penale “vjedhje me pasoja të rënda”, e kryer në bashkëpunim, nuk ka kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata. Konkretisht, për veprën penale të mësipërme janë dënuar nga gjykata dy shtetas, ndërkohë është veçuar çështja sa i përket bashkëpunëtorëve të tjerë të pidentifikuar. Në drejtim të identifikimit të autorëve kompanisë “Facebook” i janë kërkuar të dhëna, të cilat janë vlerësuar të rëndësishme për hetimin. Kallëzuesit pretendojnë se kompania në fjalë ka kërkuar disa të dhëna shtesë për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të shtruara nga organi procedues, gjë të cilën prokurorja Elida Hoxhaj nuk pranon ta realizojë. Në kushtet kur kërkesës drejtuar kompanisë “Facebook” i është dhënë udhë nga një vendim gjyqësor, kallëzuesit pretendojnë se prokurorja Elida Hoxhaj, jo vetëm nuk zbaton vendimin e gjykatës, por pengon edhe zbulimin e autorëve të veprës penale.

Lidhur me këtë kallëzim të shtetasve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, të vitit 2020. Në funksion të kallëzimit, prokurori ka kryer veprime hetimore, në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Prokurori argumenton se, ashtu si dhe pranohet nga jurisprudenca penale, asnjë subjekt nuk mund të ndërhyjë në autoritetin e prokurorit në fazën e veprimtarisë hetimore. Në

---

penal nr. \*\*\*, datë 13.3.2014. Nga shkresa nr. \*\*\*, datë 9.3.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se për vendimin e pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2013, nuk ka pasur ankim të depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. **Dosja 3** – procedimi penal nr. \*\*\*, datë regjistrimi 3.3.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Dokumenti ligjor – vendim “Për pushimin e procedimit penal”, datë 1.4.2015, për procedimin penal nr\*\*\*, regjistruar në datën 3.3.2015. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e materialeve referuar nga policia gjyqësore, ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale “dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a, 1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A.Ç.. Nga shkresa nr. \*\*\*, datë 9.3.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se për vendimin e pushimit të procedimit penal nr\*\*\*, të vitit 2013 nuk ka pasur ankim të depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. **Dosja 4** – procedimi penal nr. \*\*\*, regjistruar në datën 13.9.2016, për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit A.M. . Dokumenti ligjor – kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2016”, datë 7.10.2016, hartuar nga prokurorja Elida Hoxhaj, subjekt rivlerësimi. Në datën 18.8.2016 shërbimet e policisë pranë Komisarariatit të Policisë Fier kanë ndaluar një motomjet tip “Honda” pa targa, që drejtohej nga i pandehuri A. M. . Gjatë verifikimit të dokumentacionit ka rezultuar se shtetasi A. M. nuk ishte i pajisur me leje për drejtimin e motorit. **Dosja 5** – procedimi penal nr. \*\*\*, regjistruar në datën 21.5.2016, për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit K. Zh. . Dokumenti ligjor – kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr\*\*\*, të vitit 2016”, datë 27.5.2016, hartuar nga prokurorja Elida Hoxhaj, subjekt rivlerësimi. Në datën 20.5.2016 shërbimet e policisë pranë Komisarariatit të Policisë Fier kanë ndaluar një motomjet me targa \*\*\*, i cili drejtohej nga i pandehuri K. Zh. . Gjatë verifikimit të dokumentacionit ka rezultuar se i pandehuri nuk ishte i pajisur me leje për drejtimin e motorit.



rastin konkret, prokurori vijon të drejtojë veprimtarinë e hetimeve paraprake dhe nuk ka disponuar me një vendim përfundimtar, që të vijë në kundërshtim me vendimet e gjykatës. Pas vendimit përfundimtar të prokurorit, legjislacioni i ka krijuar mundësinë të interesuarve t'i drejtohen gjykatës me ankim. Në këtë kuptim, ligjshmëria e veprimeve të prokurorit të çështjes gjatë hetimeve paraprake janë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi vetëm nga gjykata.

Në këto rrethana, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 29.12.2020 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke u bazuar në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 290 dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale.

**ii.** Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime të detajuara në lidhje me pretendimet e kallëzuesit – për moskryerje të veprimeve hetimore të urdhëruara nga gjykata në lidhje me procedimin e regjistruar për veprën penale “vjedhje me pasoja të rënda”, e kryer në bashkëpunim – se kompania në fjalë ka kërkuar disa të dhëna shtesë për t’u dhënë përgjigje pyetjeve të shtruara nga organi procedues, gjë të cilën prokurorja Elida Hoxhaj nuk pranon ta realizojë – se prokurorja Elida Hoxhaj jo vetëm nuk zbaton vendimin e gjykatës, por pengon edhe zbulimin e autorëve të veprës penale. Po ashtu, subjektit i është kërkuar: të vërtetojë me dokumente nga dosja penale e këtij procedimi penal veprimet hetimore konkrete të kryera prej saj; të qartësojë statusin aktual të kësaj çështje; të depozitojë kopje të plotë të fashikullit penal të këtij procedimi penal, të vërtetuar nga institucioni administrues; si dhe të qartësojë se cili është aktualisht statusi i vendimit të mosfillimit të procedimit datë 29.12.2020, duke depozituar edhe dokumentacionin mbështetës.

**iii.** Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna, ka parashtruar se: *“Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr\*\*\*, datë 12.6.2017, i cili bën fjalë për veprën penale ‘vjedhje me pasoja të rënda’, e kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasve F. K. e Xh. K. .*

*Me hetimin e këtij procedimi janë ngarkuar prokurorë të tjerë të kësaj prokurorie.*

*Në përfundim të hetimeve janë dërguar për gjykim të pandehurit R. L. dhe Xh. M., të akuzuar për kryerjen e veprës penale ‘vjedhje me pasoja të rënda’, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 134/3 dhe 25 të Kodit Penal.*

*Nga hetimi ka rezultuar se të pandehurit, të cilët janë dërguar për gjykim, e kanë kryer veprën penale në bashkëpunim me persona të tjerë të paidentifikuar, për të cilët është vendosur ndarja e çështjes dhe regjistrimi i një procedimi të ri, me nr. \*\*\*, datë 14.11.2018.*

*Në lidhje me këtë procedim, pasi janë kryer të gjitha veprimet hetimore, në datën 30.7.2019 është vendosur pezullimi i hetimeve dhe aktet e procedimit penal i janë dërguar Komisarariatit të Policisë Fier, për zbulimin e bashkëpunëtorëve.*

*Kundër vendimit të pezullimit të hetimeve, datë 30.7.2019, kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier shtetasit F. K. dhe Xh. K. .*

*Unë nuk kam kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me hetimin e këtij procedimi, pasi, siç e shpjegova, me hetimin e tij janë ngarkuar prokurorë të tjerë të kësaj prokurorie, por pas kundërshtimit të vendimit të pezullimit nga shtetasit F. K. e Xh. K., jam caktuar për të përfaqësuar në gjykatë Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, në shqyrtimin e kërkesës me objekt ‘kundërshtimi i vendimit të pezullimit’, pasi prokurorja e çështjes është caktuar drejtuese e prokurorisë.*

*Caktimi im për të përfaqësuar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier në gjykatë është bërë mbi bazën e shortit të kësaj prokurorie, sipas procesverbalit për hedhjen e shortit, datë 1.10.2019. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e shtetasve F. K. e Xh. K., me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.12.2019, ka vendosur: Rrëzimin e kërkesës penale nr. \*\*\* regjistri, datë 25.9.2019, me palë kërkuese F. K. e Xh. K., me objekt ‘kundërshtim i vendimit të pezullimit të hetimeve për procedimin penal nr. 1659/2018’, si kërkesë e pabazuar në ligj e në prova. Vendimi është i formës së prerë.*

*Aktualisht procedimi penal nr\*\*\* është i pezulluar dhe aktet e tij i janë dërguar Komisarariatit të Policisë Fier për zbulimin e bashkëpunëtorëve.*

*Pretendimet e kallëzuesve janë tërësisht të pabazuara dhe të pavërteta dhe me vendim të formës së prerë kërkesa e tyre është rrëzuar, si e pambështetur në ligj e në prova”.*

Subjekti ka depozituar kopje të akteve të procedimit penal nr. \*\*\* dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 2.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Në lidhje me statusin aktual të kallëzimit penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, subjekti ka sqaruar se me vendimin datë 29.12.2020, të prokurorit, është vendosur mosfillimi i procedimit në lidhje me kallëzimin e shtetasve F. dhe Xh. K., të cilët kanë paraqitur ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Mbi këtë ankim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.6.2021 ka vendosur: *“Deklarimin të papranueshëm të apelimit (kërkesë penale) nr. \*\*\* regj. veç, datë 20.1.2021”.*

Subjekti ka depozituar shkresën nr\*\*\* prot., datë 1.7.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, aktet e kallëzimit penal nr. \*\*\*, të kësaj prokurorie, shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2021, dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 7.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**iv.** Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar, ka konstatuar se shpjegimet e subjektit qëndrojnë. Nga dokumentacioni i administruar provohet se subjekti ka përfaqësuar organin e akuzës pikërisht në shqyrtimin nga gjykata, të kërkesës me objekt “kundërshtim i vendimit të pezullimit” dhe se nuk ka qenë pjesë e hetimeve të kryera në çështjen penale të përfunduar apo në atë të ndarë dhe të pezulluar. Hetimi i çështjes, ndarja e saj dhe regjistrimi i një procedimit penal të ri, por edhe pezullimi i hetimit të këtij të fundit, rezultojnë të jenë kryer nga një tjetër subjekt rivlerësimi. Roli dhe përfaqësimi i subjektit në këtë rast nuk ka të bëjë me moskryerje të veprimeve hetimore, sikurse pretendohet nga kallëzuesit, përkundër, ajo ka ushtruar detyrën e saj në një çështje e cila ishte pezulluar dhe kishte kaluar pranë komisarariatit të policisë për veprime të tjera hetimore. Ndërkohë, edhe gjykata në shqyrtimin e çështjes ka gjykuar dhe vendosur lënien në fuqi të pezullimit të saj. Pra, në raport me pretendimet e kallëzuesve për moskryerje të detyrave të lëna nga gjykata, konstatohet se çështja nuk ka vijuar të administrohet më nga organi i akuzës, por zbulimi i bashkëpunëtorëve (që i përket procedimit penal të pezulluar), për vjedhjen e kryer në bashkëpunim, në dëm të kallëzuesve, i është lënë organeve policore. Në tërësi, trupi gjykues nuk identifikon problematika të cilat ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

➤ Mbi bazën e kërkesës për informacion, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 19.3.2021, ka bërë me dije se ndaj subjektit të rivlerësimit Elida Hoxhaj, prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Fier, janë regjistruar 2 kallëzime penale, përkatësisht me nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*.

**b/2.** Në datën 26.3.2018 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, mbi bazën e kallëzimit të kryer nga shtetasi N. D. .

**i.** Shtetasi N. D. ka kallëzuar se disa herë i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kallëzime, por nuk ka gjetur zgjidhje ligjore. Një ndër prokurorët të cilët ka trajtuar kallëzimin e shtetasit ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit Elida Hoxhaj. Kallëzuesi pretendon se edhe pse provat e vëna në dispozicion të organit të akuzës kanë qenë të plota, vendimmarrja e prokurorit ka qenë në kundërshtim me ligjin.

Për sa u përmend lidhur me këtë kallëzim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, të vitit 2018. Në funksion të kallëzimit prokurori ka kryer veprime hetimore, në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Prokurori argumenton se ashtu si edhe pranohet nga jurisprudenca penale, asnjë subjekt nuk mund të ndërhyjë në autoritetin e prokurorit në fazën e veprimtarisë hetimore. Pas vendimit përfundimtar të prokurorit, legjislacioni i ka krijuar mundësinë të interesuarve t'i drejtohen gjykatës me ankim. Gjatë hetimeve paraprake janë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi vetëm nga gjykata.

Në këto rrethana, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 28.3.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke u bazuar në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 290 dhe nenit 291 Kodit të Procedurës Penale.

**ii.** Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime të detajuara në lidhje me procedimin penal që ka ndjekur dhe hetuar (gjithnjë sipas pretendimit të këtij shtetasi) mbi kallëzimin/et e bërë/a nga shtetasi N.D., i cili pretendon se disa herë i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kallëzime, por nuk ka gjetur zgjidhje ligjore; të vërtetojë me dokumente nga dosja penale e procedimit penal veprimet hetimore konkrete të kryera prej saj; të qartësojë statusin aktual të kësaj çështjeje; të depozitohet kopje të plotë të fashikullit penal të këtij procedimi penal, të vërtetuar nga institucioni administrues; si dhe të qartësojë se cili është aktualisht statusi i vendimit të mosfillimit të procedimit (ndaj saj), datë 28.3.2018, duke depozituar edhe për këtë të fundit dokumentacionin mbështetës.

**iii.** Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar: *“Unë jam caktuar për vijimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, i cili bën fjalë për veprën penale të pushtimit të tokës, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal.*

*Ky procedim penal është regjistruar në datën 8.12.2010 dhe me hetimin e tij është ngarkuar prokurori G. M. i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.*

*Në datën 6.6.2011 prokurori ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 8.12.2010. Kundër vendimit ‘Për pushimin e procedimit penal nr.\*\*\*, datë 8.12.2010’, ka paraqitur ankim në gjykatë shtetasi N. D. dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2012, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.6.2012, ka vendosur: ‘Prishjen e vendimit të pushtimit të tokës nr. \*\*\*, për veprën penale të pushtimit të tokës’, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve për këtë çështje.*

*Pas kthimit të akteve të procedimit penal nr. \*\*\* për vazhdimin e hetimeve, prokurori i çështjes G. M., në datën 12.9.2012 ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal. Kërkesa e prokurorit është marrë në shqyrtim nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili, me vendimin e datës 24.9.2012, ka pranuar kërkesën për heqjen dorë të prokurorit dhe jam caktuar unë prokurore Elida Hoxhaj për vazhdimin e hetimeve.*

*Pas kryerjes së detyrave të urdhëruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2012, me cilësinë e prokurores së çështjes, kam vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, me vendimin datë 27.12.2012.*

*Kundër vendimit për pushimin e procedimit penal, datë 27.12.2012, ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier shtetasi N.D. .*

*Pas shqyrtimit të ankimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.6.2013, ka vendosur ‘Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit N. D., me objekt ‘ankim kundër vendimit për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 8.12.2010’, si të pabazuar në ligj dhe në prova’.*

*Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 21.6.2013, pa u ankimuar në apel”.*

Subjekti ka depozituar aktet e procedimit penal nr.\*\*\*, si dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 10.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Në lidhje me statusin aktual të kallëzimit penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, subjekti ka sqaruar se me vendimin datë 28.3.2018, prokurorit ka vendosur mosfillimin e procedimit nr. \*\*\*, në lidhje me kallëzimin e shtetasit N. D. .

Kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. \*\*\* nuk është paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës nga shtetasi N.D. .

Subjekti ka depozituar aktet e kallëzimit penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe shkresën nr. \*\*\*prot., datë 2.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**iv.** Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se shpjegimet e saj qëndrojnë. Nga verifikimi i dokumentacionit të fashikullit hetimor, që i përket procedimit nr. \*\*\*, rezultoi se subjekti ka vijuar hetimet e këtij procedimi vetëm pas kthimit të çështjes nga Gjykata e Apelit Vlorë për vijimin e hetimeve dhe kryerjen e disa detyrave të lëna dhe se, pas ankimit të ushtruar për këtë fazë hetimi nga shtetasi N. D., për shkak të pushimit të këtij procedimi nga subjekti i rivlerësimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.6.2013, ka vendosur rrëzimin e kërimit të këtij shtetasi, vendim ky i formës të prerë, pa u ankimuar. Në të tilla kushte, qartazi shihet se roli dhe detyra funksionale e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje ka nisur vetëm pas kthimit të çështjes penale për hetime të tjera, proces i cili është finalizuar me vendim gjyqësor. Për sa më sipër, trupi gjykues, referuar kërkesave të ligjit nr. 96/2016, për vlerësimin profesional të prokurorit dhe referuar kriterëve ligjore të vlerësimit nuk konstaton shkelje apo cenim të tyre dhe, për pasojë, nuk dikton problematika në drejtim të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

**b/3.** Në datën 1.10.2020 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, mbi bazën e kallëzimit të kryer nga shtetasi A. B. .

**i.** Shtetasi A. B., administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., pretendon se nga prokurorja Elida Hoxhaj është konsumuar vepra penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Nga përmbajtja e kallëzimit rezulton se në vitin 2017, pas kallëzimit të bërë prej tij, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprat penale “vjedhje, duke shpërdoruar”, “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim i dokumenteve”. Me cilësinë e viktimës së veprës penale, shtetasi A. B. pretendon se nga ana e prokurores Elida Hoxhaj, e cila ka drejtuar hetimin në këtë rast, është vepruar në kundërshtim me ligjin. Pretendimet e shtetasit kanë të bëjnë me vendimmarrjen e prokurores Elida Hoxhaj, konkretisht kërkesën për pushim. Në vlerësimin e kallëzuesit, prokurorja Elida Hoxhaj, në kërkesën për pushimin e çështjes penale drejtuar gjykatës, ka referenca të gabuara në fakt e ligj. Kërkesa për pushim është miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe pas ankimit është prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë. Kallëzuesi pretendon se prokurorja Elida Hoxhaj nuk ka kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Lidhur me këtë kallëzim të shtetasit A. B., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar kallëzimin penal nr.\*\*\*, të vitit 2020. Në funksion të këtij kallëzimi prokurori ka kryer veprime hetimore, në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Këtë konkluzion prokurori e mbështet në faktin se nëse palët në proces vlerësojnë si të padrejtë vendimmarrjen ose çdo veprim tjetër procedural të kryer nga prokurori, ligji ka parashikuar mjete dhe forma të cilat mund të përdoren brenda afateve procedurale për t’u ankuar në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Janë pikërisht këto organe (hierarkike dhe gjyqësore) të cilët vlerësojnë ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorit. Prokurori argumenton se nga hetimi nuk rezultoi që shtetasja Elida Hoxhaj, në cilësinë e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të ketë kryer ndonjë veprim

në mospërmbushje të rregullt të detyrës dhe në mbështetje të germës “ç”, të nenit 290/1, të Kodit Procedurës Penale ka vendosur mosfillimin si procedim penal të kallëzimit të bërë nga shtetasi A. B. .

**ii.** Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime të detajuara në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*, që i përket kallëzimit të bërë nga shtetasi A.B. në vitin 2017, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për veprat penale “vjedhje, duke shpërdoruar”, “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim i dokumenteve”, duke i cituar se shpjegimet duhet të konsistojnë në pretendimet e kallëzuesit, se: (i) nga ana e prokurores Elida Hoxhaj, e cila ka drejtuar hetimin, në këtë rast është vepruar në kundërshtim me ligjin, duke pushuar çështjen; (ii) në vlerësimin e kallëzuesit, prokurorja Elida Hoxhaj, në kërkesën për pushimin e çështjes penale drejtuar gjykatës, ka referenca të gabuara në fakt e ligj; (iii) kërkesa për pushim është miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe pas ankimimit është prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë; dhe se (iv) prokurorja Elida Hoxhaj nuk ka kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga Gjykata e Apelit Vlorë; të vërtetojë me dokumente nga dosja penale e procedimit penal veprimet hetimore konkrete të kryera prej saj; të qartësojë statusin aktual të kësaj çështjeje; të depozitohet kopje të plotë të fashikullit penal të këtij procedimi penal, të vërtetuar nga institucioni administrues, duke përfshirë edhe vendimmarrjet e gjyqësorit; si dhe të qartësojë se cili është aktualisht statusi i vendimit të mosfillimit të procedimit që i përket kallëzimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2020, duke depozituar për këtë të fundit dokumentacionin mbështetës.

**iii.** Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar: *“Në datën 2.9.2017 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A.B., ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, i cili bën fjalë për veprat penale ‘vjedhje, duke shpërdoruar detyrën’, ‘shpërdorim detyre’ dhe ‘falsifikim i dokumentave’, parashikuar nga nenet 135, 248 dhe 186 të Kodit Penal.*

*Shtetasi A. B. ka kallëzuar se shtetasi A. K., përmbartues gjyqësor, A. F., drejtor i ‘Credins Bank’, Fier dhe F. Xh., me detyrë përgjegjës i sektorit të kredive në ‘Credins Bank’, gjatë vënies në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit në lidhje me kreditë e marra prej tij pranë ‘Credins Bank’ kanë dëmtuar interesat e ligjshme të kallëzuesit dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.*

*Kallëzuesi A. B. pretendon se nuk është vënë në dijeni nga ‘Credins Bank’ që kreditë e tij ishin kategorizuar si kredi të këqija dhe në mënyrë abuzive kjo bankë ka vazhduar me procedurat gjyqësore e përmbartimore për rikthimin e shumave të marra, duke deformuar realitetin. Kallëzuesi pretendon se ka qenë një pagues i rregullt i kredive të marra në ‘Credins Bank’ dhe me veprimet abuzive të saj i janë dëmtuar rëndë interesat pasurore të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., dhe hipotekuesit S. B. . Ky shtetas pretendon se janë paguar plotësisht këstet e kredive dhe banka nuk mund të niste procedurat për ekzekutimin në mënyrë të detyrueshme nëpërmjet zyrës përmbartimore, duke vendosur sekuestron dhe nxjerrë në ankand pronat për shitjen e tyre.*

*Po ashtu, kallëzuesi A. B. pretendon se përmbartuesi gjyqësor A. K., në kundërshtim me dispozitat ligjore të Kodit Civil, ka shpërdoruar detyrën, pasi shoqëria përmbartimore \*\*\* nuk e ka njoftuar në mënyrë ligjore për veprimet përmbartimore që po kryente, se është ngarkuar me një detyrim që nuk ekziston nga ‘Credins Bank’ vetëm me qëllim për t’i marrë e tjetërsuar pronat në mënyrë abuzive nga kjo bankë dhe zyra përmbartimore.*

*Pas regjistrimit të procedimit penal në datën 2.9.2017, nga ana e prokurorit është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore dhe oficeri i policisë gjyqësore ka administruar provat shkresore, si dosja përmbartimore, vendime gjyqësore, etj., në lidhje me objektin e kallëzimit, janë pyetur shtetasit A. B., të kallëzuarit A.K., A.F., F. Xh., etj.*

*Nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, pas kryerjes së veprimeve hetimore, është përpiluar relacioni përkatës mbi kryerjen e veprimeve hetimore dhe mënyrën e përfundimit të çështjes, duke sugjeruar pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*.*

Duke analizuar faktin e kallëzuar, elementët e veprave penale 'shpërdorim detyre', 'vjedhje, duke shpërdoruar detyrën', si dhe rezultatet e hetimeve paraprake, bazuar në parashikimet e nenit 328/1, germa 'b' e Kodit të Procedurës Penale, në datën 13.11.2018 është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier kërkesa për pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, në lidhje me veprat penale 'shpërdorim detyre' dhe 'vjedhje, duke shpërdoruar detyrën', parashikuar nga nenet 248 dhe 135 të Kodit Penal dhe për shkak të plotësisimit të afateve të parashkrimit të ndjekjes penale në lidhje me veprën penale 'falsifikim i dokumenteve', parashikuara nga neni 186/1 i Kodit Penal.

Nga ana e prokurorit nuk janë veprime në kundërshtim me ligjin dhe kërkesa për pushimin e procedimit është rezultat i analizës së provave dhe ligjit penal e procedural.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.1.2019, ka vendosur: 'Pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 7.9.2017'. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë shtetasi A. B. . Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.2.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.\*\*\*, datë 15.1.2019, rrëzimin e kërkesës, duke urdhëruar organin procedues të vazhdojë hetimet, sipas drejtimit të përcaktuar në pjesën arsyetuese të tij. Gjykata e apelit ka konkluduar se nuk ka vend për përgjegjësinë penale të të kallëzuarve A. F., drejtor i 'Credins Bank', Fier dhe F. Xh., me detyrë përgjegjës i sektorit të kredive në 'Credins Bank', veprimtaria e të cilëve është kryer në kuadër të detyrës së tyre që kanë kryer pranë kreditorit dhe nuk kanë pasur ndikim mbi veprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.2.2019, i cili është vendim i formës së prerë, ka arsyetuar se përmbaruesi gjyqësor, me mosveprimin e tij, ka cenuar interesat e kallëzuesit dhe në lidhje me veprën penale 'falsifikim i dokumenteve', kjo vepër në eventualitet duhej të cilësohej sipas paragrafit të tretë të nenit 186 të Kodit Penal, pasi edhe pretendimet e kallëzuesit lidhen me përmbaruesit gjyqësorë që kanë ndjekur procedurën përmbarimore. Sipas vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Vlorë, për veprën penale 'falsifikim i dokumenteve' nga personi që ka për detyrë të lëshojë aktin dhe atë të 'shpërdorimit të detyrës' nga ana e përmbaruesit gjyqësor A. K., hetimet duhet të vazhdojnë. Nga analiza e fakteve dhe provave të paraqitura më sipër, urdhërimet sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 26.2.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë, rezulton se vepra penale 'shpërdorim detyre', e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilin është nisur ky procedim penal, ka ndodhur/është kryer në qytetin e Tiranës. Në qytetin e Tiranës, ndodhet qendra/selia e zyrës përmbarimore private, shërbimit përmbarimor '\*\*\*' sh.p.k, në të cilën ushtron aktivitetin e tij si përmbarues gjyqësor privat personi që i atribuohet kryerja e veprës penale 'shpërdorim detyre', etj. Në qytetin e Tiranës, në qendrën e tyre të punës, janë kryer të gjitha veprimet/janë marrë vendimet për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, vendime të cilat vlerësohen dhe kallëzohen nga shtetasi A. B. si të marra në kundërshtim me ligjin. Për këto arsye, në respektim të nenit 76/1 të Kodit të Procedurës Penale, për këtë procedim penal është konstatuar moskompetenca tokësore për vazhdimin e hetimeve nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe aktet i janë dërguar për kompetencë tokësore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si prokuroria kompetente. Kjo e fundit, si prokuroria që ka kompetencën tokësore për hetimin e procedimit, ka pranuar aktet e procedimit penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke e regjistruar procedimin me nr. \*\*\* dhe për këtë arsye, nga ana ime nuk janë kryer veprime të urdhëruara nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.2.2019, siç pretendon ankuesi. Mbi bazën e kërkesës sime, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë më ka dërguar aktet e procedimit penal nr.\*\*\*. Nga aktet e këtij procedimi rezulton se organi procedues, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 26.12.2019 ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për pushimin e procedimit penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. regj. them. S.P \*\*\*, datë 1.7.2020, ka vendosur: 'Kthimin e akteve të procedimit penal nr. \*\*\*, datë 31.7.2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për

*vazhdimin e hetimeve'. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë prokurorja e çështjes dhe çështja ndodhet për gjykim pranë kësaj gjykate”.*

Subjekti ka depozituar aktet e procedimit penal nr\*\*\*, datë 31.7.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (\*\*\*), bashkë me vendimmarrjet e gjyqësorit.

Në lidhje me kërkesën për statusin aktual të kallëzimit penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, subjekti ka sqaruar se me vendimin datë 19.10.2020, prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit nr. \*\*\*, në lidhje me kallëzimin e shtetasit A. B. . Kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. \*\*\* shtetasi A. B. nuk ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Subjekti ka depozituar aktet e kallëzimit penal nr. \*\*\*, si dhe shkresën nr\*\*\*prot., datë 2.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**iv.** Trupi gjykues, në analizë të parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar, vëren se Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, ka arsyetuar hollësisht mbi: (i) moskryerjen e veprimeve hetimore nga subjekti i rivlerësimit në këtë çështje penale, kryesisht lidhur me pretendimin e kallëzuesit për objektin e veprës penale falsifikim i dokumenteve”, si dhe (ii) mosarsyetimin e mjaftueshëm nga subjekti në lidhje me çmuarjen e provave sipas kritereve logjike dhe juridike të parashikuara nga neni 152 i Kodit të Procedurës Penale. Pra në tërësi, gjykata, me vendimmarrjen e saj, është shprehur lidhur me ligjshmërinë e vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit. Në këtë rast, produktiviteti dhe roli i prokurorit, bazuar në kriteret matëse të vlerësimit profesional, sikurse parashikojnë nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, duket se nuk është në nivelin e kërkuar. Më konkretisht, duket se çështja ka qenë e përzier, me disa objekte të veprës penale, me disa palë, me pretendime të ndërsjella që drejtpërsëdrejti apo indirekt kanë cenuar interesa pronësore të kallëzuesit, por edhe kredimarrje, janë ndërthurur e pretenduar çështje ekzekutimi të urdhrave të ekzekutimit apo njoftime të pakryera nga palët në hetime, pra në tërësi, hetimi nga subjekti i rivlerësimit është shtrirë në kohë, ndërsa ka rezultuar edhe i paplotë.

**c.** Gjithashtu, raporti i vlerësimit profesional në të dhënat arkivore lidhur me ankesat ka pasqyruar se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën 2006 – 2020, ndaj subjektit të rivlerësimit kanë rezultuar 4 ankesa. Komisioni, pas analizimit të tyre, ka vlerësuar t'i kërkojë subjektit të rivlerësimit shpjegime dhe dokumentacion. Në vijim, jepen të dhëna mbi ankesat e depozituara, si dhe kërkimet e Komisionit.

**c/1.** Praktika nr. \*\*\*, datë 27.2.2018, regjistruar pas ankesës së shtetasës R. I., drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm ndaj prokurores Elida Hoxhaj.

**i.** Shtetasja R.I., në vitin 2016 ka bërë një denoncim pranë një emisioni investigativ, ku ka denoncuar kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, shtetasin G. B. . Konkretisht, kjo shtetase ka pretenduar se prej një periudhe 10-mujore është shantazhuar në forma nga më të ndryshmet nga shtetasi G.B., i cili, duke shfrytëzuar pozitën e tij si gjyqtar në një çështje me palë shtetasen R. I., i ka kërkuar favore të natyrës seksuale. Pas shfaqjes së këtij denoncimi në televizion Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka filluar hetimet lidhur me rastin. Pas kryerjes se veprimeve hetimore Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka shpallur moskompetencën lëndore dhe çështja në fjalë i është përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Me drejtimin e hetimit në lidhje me këtë çështje penale është ngarkuar prokurorja Elida Hoxhaj. Pas veprimeve hetimore, prokurorja Elida Hoxhaj ka disponuar me vendim pushimi. Ankuesja pretendon se vendimi i pushimit i është njoftuar me vonesë nëpërmjet postës me qëllim që mos të ankimohej nga kallëzuesi. Pasi është njohur me vendimin e pushimit, shtetasja R. I., në ankesën e saj,

pretendon për një hetim jo të plotë dhe të njëanshëm me qëllim favorizimin e personit ndaj të cilit u zhvilluan hetimet. Shtetasja R. I. e ka ankimuar vendimin e pushimit dhe si rezultat, me vendimin e datës 25.5.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka pranuar kërkesën e saj, duke prishur vendimin e prokurorisë. Pasi prokurorja Elida Hoxhaj ka ushtruar të drejtën e ankimit, Gjykata e Apelit Vlorë, në datën 27.9.2018 ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke lënë në fuqi vendimin e pushimit të prokurorisë.

Në këto rrethana, shtetasja R. I. është drejtuar me ankesë në lidhje me veprimtarinë e prokurorit gjatë ushtrimit të funksionit, e cila është marrë në shqyrtim nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme. Me shkresën nr\*\*\* prot., datë 29.10.2018, ankueses R. I. i është kthyer përgjigje se Prokuroria e Përgjithshme nuk ka asnjë kompetencë ligjore të vlerësojë drejtësinë e vendimeve të gjykatës. Vendimet e gjykatës kontrollohen vetëm nga sistemi i konsoliduar gjyqësor nëpërmjet mjeteve dhe afateve të ankimit dhe asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e tyre, për sa kohë nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë.

**ii.** Për sa më sipër referohet, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime, si dhe të qartësojë se cili është aktualisht statusi i kësaj çështjeje, pra nëse çështja është rekursuar, duke depozituar edhe dokumentacionin mbështetës.

**iii.** Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Vendimi i pushimit të procedimit penal i është dërguar ankueses nëpërmjet shërbimit postar. Pretendimi i saj se vendimi i është njoftuar me vonesë nëpërmjet postës, me qëllim që të mos ankimohej nga kallëzuesi, është i pabazuar dhe i pavërtetë. Fakti që vendimi i është dërguar me shërbimin postar me vonesë, nuk është bërë me qëllim që vendimi për pushimin e procedimit të mos ankimohej nga shtetasja, pasi afati i ankimit kundër vendimit të pushimit, referuar parimeve të përgjithshme në lidhje me afatet e ankimit (neni 415/1 i Kodit të Procedurës Penale), llogaritet nga e nesërmja e marrjes dijeni për vendimin. Në këtë mënyrë, ankueses nuk i është cenuar asnjë e drejtë në lidhje me të drejtën e ankimit dhe afatin e paraqitjes së ankimit. Në lidhje me pretendimin e ankueses R. I., se hetimet e kryera në lidhje me çështjen nuk janë të plota, se janë të njëanshme, me qëllim favorizimin e personit nën hetim G. B., sqaroj se hetimet në lidhje me çështjen janë të plota, objektive dhe nuk kanë pasur aspak për qëllim favorizimin e personit nën hetim, shtetasit G. B. . Nga ana e organit procedues është konstatuar se veprimet e personit nën hetim G. B. përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës Gjyqësore dhe, për këtë shkak, me shkresën nr\*\*\* prot., datë 5.6.2017, kopja e vendimit i është dërguar ministrit të Drejtësisë, me qëllim që organi kompetent të vlerësojë përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit për shkeljen e etikës së gjyqtarit.*

*Për sa i përket kërkesës së Komisionit në lidhje me statusin aktual të çështjes, sqaroj se kundër vendimit për pushimin e procedimit penal nr\*\*\*, në ngarkim të personin nën hetim G. B., ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier shtetasja R. I. . Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.7.2018, ka vendosur prishjen e vendimit datë 25.5.2017, ‘Për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*’, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve.*

*Duke qenë se veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata ishin ezauruar gjatë hetimit, nga ana e prokurorit është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr\*\*\*, datë 27.9.2018, në lidhje me vendimin e mësipërm, ka vendosur: ‘Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 25.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si vijon: Rrëzimin e ankimit të ankueses R. I. . Kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 27.9.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë shtetasja R. I. . Sipas shkresës nr\*\*\*, datë 12.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier çështja ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Sipas shkresës nr. \*\*\*prot., datë 8.2.2019, të Gjykatës së Lartë dhe nga këqyrja e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, në datën 1.7.2021 rezulton se në Gjykatën e Lartë është regjistruar dosja*



*penale me palë R.I., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me nr. \*\*\*, datë 28.12.2018. Çështja ndodhet në pritje për të kaluar në dhomën e këshillimit”.*

Subjekti ka depozituar shkresën nr. \*\*\*, datë 12.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shkresën nr. \*\*\*prot, datë 8.2.2019, të Gjykatës së Lartë, si dhe informacionin e nxjerrë nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë më 1.7.2021.

**iv.** Trupi gjykues, nisur nga fakti se kjo shtetase njëkohësisht ka depozituar edhe denoncim pranë Komisionit, thuajse me të njëjtin objekt ankimi, por gjithashtu çështja e saj është bërë publike në media dhe më konkretisht në emisionin investigativ “Stop” në TV Klan, ka vlerësuar të trajtojë dhe të analizojë prapësimet e subjektit të rivlerësimit ndaj pretendimeve të saj, të paraqitura në vijim, nën titullin “Çështje të tjera”.

**c/2.** Praktika nr. \*\*\*, datë 15.7.2019, regjistruar pas ankesës së shtetasit Th. Ç., drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme ndaj prokurores Elida Hoxhaj.

**i.** Ankuesi Th. Ç. pretendon se ka bërë kallëzim në lidhje me një veprimtari kriminale, e cila ka të bëjë me trafikimin e mjeteve motorike, për të cilën prokurorja Elida Hoxhaj ka disponuar me vendim. Në pretendimet e ankuesit, prokurorja Elida Hoxhaj është bërë palë me trafikantët. Në këto rrethana, shtetasi Th. Ç. është drejtuar me ankesë në lidhje me veprimtarinë e prokurorit gjatë ushtrimit të funksionit, e cila është marrë në shqyrtim nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.6.2018, ankuesit i është kthyer përgjigje se për sa kohë procedimi penal është në proces gjykimi, si në rastin konkret, ligjshmëria e veprimeve të prokurorit të çështjes gjatë hetimeve paraprake janë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi vetëm nga gjykata. Në këto kushte, ankuesi sugjerohet të presë vendimin gjyqësor dhe, nëse do ketë pretendime lidhur me shkeljen e të drejtave, të ushtrojë ankimin konform dispozitave përkatëse ligjore.

Gjithashtu, ky shtetas ka depozituar edhe denoncim me të njëjtin objekt ankimi pranë Komisionit. Nga verifikimi i akteve shoqëruese të denoncimit rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën 22.12.2011 ka vendosur pushimin e pjesshëm të procedimit penal nr. \*\*\*, regjistruar për veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal. Ky procedim është bashkimi i dy procedimeve, ku përfshihet edhe ai nr. \*\*\*, datë 17.12.2010, regjistruar për veprën penale “mashttrim”, nën pretendimin e shtetasit Th. Ç. se disa persona, të cilët i ka kallëzuar, i kanë vjedhur nëpërmjet mashtimit shumë 25.000 euro. Në kallëzim shtetasi Th.Ç. ka denoncuar trafikimin në Republikën e Shqipërisë të disa mjeteve motorike të vjedhura në shtetin grek. Subjekti i rivlerësimit ka pushuar procedimin penal për veprën e mashtimit. Në arsyetimin e vendimit trajtohet gjerësisht bashkëpunimi i shtetasit Th. Ç. me persona të cilët më pas i ka kallëzuar, komunikimet e tyre dhe dhëniet e shumave të caktuara në kuadër të bashkëpunimit për të hyrë në veprimtari ndërtimore, etj. Në vendim qartësohet se nuk janë provuar vjedhjet me anë të mashtimit, sikurse pretendohet në kallëzimin e shtetasit Th. Ç. .

**ii.** Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime, të qartësojë se kur është regjistruar ky procedim penal, cilat janë veprimet hetimore të kryera, të sqarojë nëse ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim dhe cili është aktualisht statusi i kësaj çështjeje, të depozitojë dokumentacion në mbështetje të shpjegimeve, si dhe të dhëna mbi statusin ligjor të vijueshmërisë së veprimeve hetimore lidhur me pjesën tjetër për të cilën nuk është pushuar procedimi, pra, për veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, së bashku me dokumentacionin justifikues.

**iii.** Subjekti, ndër të tjera, në shpjegimet e saj ka sqaruar se: *“Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e materialeve të referuara nga oficeri i policisë gjyqësore, në datën 6.10.2010 ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale ‘trafikim i mjeteve motorike’,*

parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, i cili bën fjalë për trafikimin në Shqipëri të automjetit tip 'Suzuki', me targa \*\*\*, i vjedhur në shtetin grek.

Në datën 17.12.2010 pranë kësaj prokurorie është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, për veprën penale 'mashtrim', parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, pasi shtetasi Th. Ç. ka kallëzuar se shtetasit F. H. e V.H. i kanë vjedhur me anë të mashtrimit shumën prej 25.000 euro. Në këtë kallëzim, shtetasi Th. Ç. ka denoncuar edhe trafikimin në Republikën e Shqipërisë të disa mjeteve motorike të vjedhura në shtetin grek, ndërmjet të cilëve edhe automjeti tip 'Suzuki', me targa \*\*\*. Me vendimin e drejtuesit të prokurorisë, datë 12.4.2011, është vendosur bashkimi i këtyre dy procedimeve në një procedim të vetëm, me nr. \*\*\*. Me hetimin e këtij procedimi jam ngarkuar unë, prokurore Elida Hoxhaj. Nga ana e prokurorit është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore në lidhje me procedimin e mësipërm dhe oficeri i policisë gjyqësore, në zbatim të urdhrit për kryerjen e veprimeve hetimore, ka administruar provat shkresore, si dhe ka pyetur personat që kanë dijeni për veprën penale, kallëzuesin Th. Ç., shtetasit F.H., B. B. dhe F.N. . Në lidhje me veprën penale të mashtrimit hetimet kanë qenë të plota dhe, për këtë arsye, me vendimin e datës 22.10.2011, nga ana ime si prokurore e çështjes është vendosur pushimi i pjesshëm i procedimit penal nr. \*\*\*, në lidhje me veprën penale të mashtrimit. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier shtetasi Th.Ç. dhe në lidhje me këtë ankim ka disa vendimmarrje nga ana e gjyqësorit, konkretisht: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.1.2013, ka vendosur: 'Rrëzimin e ankimit të ankuesit Th. Ç., kundër vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, të datës 22.12.2011, 'Për pushimin e pjesshëm të procedimit penal nr. \*\*\*'. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.12.2014, Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur: 'Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 25.1.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kthimin e akteve për rigjykim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues'. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr\*\*\*, datë 21.7.2016, ka vendosur: 'Pushimin e gjykimit të çështjes penale nr. \*\*\* regjistri, datë 21.1.2015/2016 regjistrimi, me palë ankuese Th. Ç., me objekt 'ankim kundër vendimit të pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*', marrë në datën 22.12.2011, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.10.2017, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: 'Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 21.7.2016, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në të njëjtën gjykatë, me një tjetër trup gjykues. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.9.2018, ka vendosur: 'Pranimin e ankimit. Shfuqizimin e vendimit 'Për pushimin e pjesshëm të procedimit penal nr. \*\*\*', datë 22.12.2010, duke urdhëruar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier të vijojë hetimet, sipas disponimit të pjesën arsyetuese të vendimit. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.11.2019, ka vendosur: 'Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 24.9.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier'. Në seancën gjyqësore të datës 12.9.2018 (gjatë gjykimit të ankimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, nr. \*\*\*, datë 19.11.2019), kur nga ana ime është paraqitur diskutimi përfundimtar në lidhje me kërkesën e shtetasit Th.Ç., ky i fundit ka kërkuar fjalën për replikë dhe, ndër të tjera, ka deklaruar para gjykatës: 'Prokurorja është bërë palë me grupin tjetër. Kam vajtur në zyrë dhe i kam deklaruar se ke marrë rryshfet'. Për shpifjet e shtetasit Th. Ç. në adresën time, të bëra me qëllim prej tij në seancë gjyqësore, për të më fyer mua si prokurore, unë kam paraqitur kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.5.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka deklaruar fajtor të pandehurin Th. Ç. për kryerjen e veprës penale "fyerje e gjyqtarit" dhe në bazë të nenit 318 të Kodit Penal e ka dënuar me 100.000 lekë gjobë. Për të shmangur çdo dyshim për paanësi në hetimin e çështjes, në datën 23.1.2019 i kam paraqitur drejtueses së prokurorisë kërkesë për heqjen dorë nga hetimi i çështjes, kërkesë e cila është pranuar. Me vazhdimin e hetimeve të këtij procedimi është ngarkuar prokurori i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, P. V., i cili në datën 1.3.2021 ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier kërkesën për pushimin e ndjekjes penale në lidhje me veprën penale të

*parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Çështja po gjykohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier”.*

Subjekti ka depozituar vendimet e sipërcituara: vendimin nr. \*\*\*, datë 25.1.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; vendimin nr. \*\*\*, datë 3.12.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë; vendimin nr. \*\*\*, datë 21.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; vendimin nr. \*\*\*, datë 11.10.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë; vendimin nr.\*\*\*, datë 24.9.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; vendimin nr. \*\*\*, datë 19.11.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë; mendim pakice të gjyqtarit P.A.; vendimin nr. \*\*\*, datë 24.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; kërkesën e subjektit për heqjen dorë nga hetimi i procedimit, datë 23.1.2019; vendimin e drejtuesit të prokurorisë për pranimin e kërkesës për heqjen dorë dhe zëvendësimin e prokurorit; si dhe kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*, të vitit 2010, datë 1.3.2021.

Në vijim të informimit mbi statusin aktual të çështjes në lidhje me veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, subjekti ka sqaruar se pas marrjes së vendimit të mësipërm për pushimin e ndjekjes penale për veprën penale “mashttrim”, në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, me cilësinë e prokurores së çështjes është vendosur pezullimi i hetimeve në pritje të ekzekutimit të kërkesës për ndihmë juridike për identifikimin e personave që kishin kryer trafikimin. Pas pezullimit të hetimeve në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, duke qenë se ndaj të kallëzuarve kishte edhe procedime të tjera të regjistruara, hetimi i mëtejshëm i procedimit i është ngarkuar shtetas V. Sh., prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Pas administrimit të materialeve të dërguara në ekzekutim të letërporosisë, prokurorja e ngarkuar me hetimin e procedimit në lidhje me veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, me vendimin e datës 18.7.2017 ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*.

Subjekti ka depozituar vendimin për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2010, datë 18.7.2017, dhe shkresën datë 7.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

**iv.** Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qartësuar hollësisht procedurën e ndjekur me këtë çështje penale, duke sqaruar edhe pozicionin e saj (pasi ajo nuk ka vijuar me hetimet e mëtejshme të çështjes) në vijimin e çështjes pas disa vendimmarrjeve të gjykatave mbi ankimin e ushtruar nga kallëzuesi. Në kushte të tilla, trupi gjykues nuk vëren problematika që ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

**c/3.** Praktika nr. \*\*\*, datë 12.8.2020, regjistruar pas ankesës së shtetasit A.B., drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ndaj prokurores Elida Hoxhaj.

**i.** Shtetasi A. B., administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me cilësinë e kallëzuesit në tri procedime penale të regjistruara nga Prokuroria e Rrethit Fier, ka paraqitur një kërkesë me objekt “zëvendësimin e prokurores Elida Hoxhaj me një prokuror tjetër”. Ankuesi pretendon se prokurorja Elida Hoxhaj ka disponuar me vendime pushimi për të tria kallëzimet e bëra nga ky shtetas. Ankuesi evidenton se ka ndjekur rrugën ligjore, duke ankimuar vendimet e organit të prokurorisë ku gjykata ka vendosur të prishë vendimet e pushimit, ndërkohë ka hasur në zvarritje hetimesh nga prokurorja Elida Hoxhaj. Në këto rrethana, shtetasi A.B. është drejtuar me kërkesën sa më lart u përmend, e cila, pasi është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, është arkivuar prej tyre, duke vlerësuar se është kompetencë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Fier.

**ii.** Për sa më sipër referohet, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me pretendimet e ankuesit, të depozitojë vendimet e pushimit ndaj kallëzimeve të bëra nga ky shtetas, si dhe të qartësojë mbi statusin aktual të tyre, pas kthimit për hetime të mëtejshme (sikurse pretendohet nga denoncuesi).

iii. Subjekti, ndër të tjera, në shpjegimet e saj, ka parashtruar: “Në bazë të shortit elektronik jam ngarkuar me hetimin e procedimit penal nr. \*\*\*. Ky procedim është regjistruar në datën 31.7.2019, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A. B., për veprën penale ‘kanosje, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Kallëzuesi A. B. ka pretenduar se është trashëgimtar i pasurisë së babait të tij S.B., pasi me vendimin nr\*\*\*, datë 28.1.2000, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, këtij të fundit i është njohur e drejta e pronësisë mbi një sipërfaqe 40,39 ha tokë pyll dhe kullotë, që ndodhet në P. Fshat, P. dhe në fshatin K. të komunës R. . Në lidhje me këto pasuri janë pajisur me certifikatë pronësie që nga viti 2001 dhe vitet 2007 - 2008. Në pasurinë prej 1,2 ha tokë pyll, që ndodhet në P. Fshat të komunës P., për të cilën kallëzuesi A.B. disponon certifikatat e pronësisë nr\*\*\*, datë 25.9.2008, dhe nr\*\*\*, datë 26.9.2008, ai pretendon se i vidhet materiali rërë bituminoze dhe kjo i shkakton dëm të konsiderueshëm material, pasi i duhet të harxhojë qindra miliona lekë për të mbyllur dhe rrafshuar tokën. Kjo vjedhje i bëhet që nga viti 2000 dhe ai vazhdimisht i është drejtuar organeve kompetente me kallëzim. Sipas pretendimeve të shtetasit A. B., në vitin 2000 ka bërë kallëzim ndaj firmës ‘\*\*\*’ sh.p.k. për vjedhje, në vitin 2010 ka bërë sërish kallëzim për këtë firmë, me administrator M.R., për vjedhje. Nga viti 2012 e deri tani çdo vit ka bërë kallëzim penal për personat që vjedhin dhe shkatërrojnë pronën. Kallëzuesi ka pretenduar se deri në vitin 2015 në pronën e tij ka vjedhur rërë bituminoze shtetasi S. B., dhe pasi është pajisur me leje minerale dhe mjedisore në vitin 2015, ky shtetas, në dijeninë e tij, i ka shitur licencën subjektit ‘\*\*\*’ sh.p.k. shtetasit A. D., me administrator M.R. dhe që nga ky moment nuk është vjedhur më nga S.R. . Më vonë, ish-kryetari i komunës P., në bashkëpunim me disa firma të ndërtimit të rrugëve, vazhduan dhe vazhdojnë aktualisht deri në ditën e sotme të vjedhin rërë bituminoze në pronën e tij. Sipas kallëzimit vazhdojnë të vjedhin rërën bituminoze firma ‘\*\*\*’ e shtetasit A. Ç., në bashkëpunim me shtetasin A. Sh. . Kallëzuesi pretendon se ka vënë në dijeni SPZ-në e zonës P., shtetasin R. H., por nuk ka gjetur zgjidhje, pasi shtetasit S.M., B. K. dhe Xh. B., me porosi të shtetasit A. Sh., e kanë kërcënuar me jetë që të mos afrohet në pronat e tij. Ai personalisht nuk është takuar ndonjëherë me shtetasin A.Ç., por ka komunikuar disa herë në telefon dhe ky i fundit i është shmangur takimit me të, duke pretenduar se ndodhet jashtë vendit. Nga hetimet e kryera nuk u provua kanosja në dëm të shtetasit A. B. dhe kanosja e pretenduar prej tij nuk ka qenë serioze dhe reale. Për këtë arsye, bazuar në nenin 328/1, germa ‘b’, me vendimin datë 28.5.2020, është vendosur pushimi i procedimit penal për veprën penale ‘të kanosjes’. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim shtetasi A. B. . Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.7.2020, ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. \*\*\*, për veprën penale ‘kanosje’, duke urdhëruar të hetohet në lidhje me veprën penale ‘vjedhje’, për të cilën është paraqitur edhe kallëzimi penal, dhe më pas, organi procedues t’i drejtohet gjykatës me kërkesën përkatëse. Në këto rrethana, me urdhrin e datës 17.9.2020, në regjistrimin e njoftimit të veprave penale është shënuar edhe vepra penale ‘vjedhje’, e parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. Pas kryerjes së detyrave të urdhëruara nga gjykata me vendimin e mësipërm, në bazë të nenit 328/1, germa ‘b’, dhe nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 5.3.2021 është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier kërkesa për pushimin e procedimit në lidhje me veprën penale ‘vjedhje’, pasi nga hetimet e kryera rezultoi se shfrytëzimi i rërës bituminoze, për të cilën ka pretendime ankuesi, bëhet nga Bashkia Fier, në bazë të lejeve përkatëse dhe në sipërfaqet në pronësi të Bashkisë Fier. Po ashtu, nga ana e prokurorit, pas kryerjes së veprimeve hetimore të urdhëruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.7.2020, u vendos pushimi i procedimit penal për veprën penale ‘kanosje’, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Kundër këtij vendimi paraqiti përsëri ankim shtetasi A.B. . Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila mori në shqyrtim si kërkesën e prokurorisë për pushimin e procedimit në lidhje me veprën penale ‘vjedhje’, ashtu edhe kërkesën e ankuesit për prishjen e vendimit të pushimit në lidhje me veprën penale ‘kanosje’, me vendimin \*\*\*, datë 1.6.2021, ka vendosur: ‘Pranimin e kërkesës

*së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, me datë rregjistrimi 31.7.2019, për veprën penale ‘vjedhje’, parashikuar nga neni 134/3 i Kodi Penal. Lënien në fuqi të vendimit të pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, për veprën penale të kanosjes, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal’”.*

Subjekti ka depozituar vendimet e pushimit të procedimit penal në lidhje me veprën penale “të kanosjes”, vendimin nr. \*\*\*, datë 1.6.2021, dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 20.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

**iv.** Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, vëren se kallëzimi i depozituar nga denoncuesi A.B. në datën 17.7.2019, ka pasur si objekt të veprës penale “vjedhje e pasurisë private më shumë se një herë”, me pasoja të rënda, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 134/3, 84 dhe 25 të Kodit Penal. Ndërsa, subjekti i rivlerësimit për këtë kallëzim të regjistruar me procedimin penal nr. \*\*\*, ka vendosur pushimin e procedimit për veprën penale “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Në tërësi të shpjegimeve të subjektit vërehet përqëndrimi i saj në përsëritjen e vendimit të pushimit, ndërsa nuk shpjegon mbi moshetimin e veprës penale të kallëzuar nga kallëzuesi. Me gjithë vendimmarrjen e pushimit për veprën penale “kanosje”, në arsyetimin e vendimit, ndër të tjera, citohet se nga hetimet e kryera në lidhje me pretendimet e kallëzuesit ka rezultuar se kjo vjedhje i bëhet nga viti 2000 dhe se vazhdimisht i është drejtuar organeve kompetente me kallëzim. Po ashtu, në vendim pasqyrohet se nga kallëzuesi pretendohet për kallëzime të tij nga viti 2012 e në vijim për persona që vjedhin e shkatërrojnë pronën e tij. Pikërisht këtë mangësi ka vërejtur edhe gjykata (mbi ankimin e kallëzuesit), e cila ka vendosur kthimin e çështjes dhe regjistrimin e procedimit penal për akuzën e vjedhjes, sikurse ishte kërkuar nga kallëzuesi, por njëkohësisht edhe kryerjen e disa detyrave të tjera të cilat i ka vlerësuar të pakryera në lidhje me hetimet e kryera për akuzën “e kanosjes”. Në të tilla kushte, subjekti duket të mos ketë qenë produktiv në hetimin e kësaj çështjeje, duke vepruar në këtë mënyrë jo sipas kërkesave të neneve 73/2 dhe 74/4 të ligjit nr. 96/2016.

**c/4.** Praktika nr. 25, e vitit 2020, regjistruar pas ankesës së shtetasës F.K., drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme ndaj prokurores Elida Hoxhaj. Ankesa e shtetasës ka për objekt veprimtarinë e prokurores Elida Hoxhaj (me të njëjtin objekt shtetasja ka bërë kallëzim penal sa më lart është evidentuar, kallëzimi penal nr. \*\*\*, regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Vlorë).

Me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 14.2.2020, Prokuroria e Përgjithshme e ka dërguar ankesën e shtetasës për zgjidhje ligjore Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

**i.** Për sa më sipër referohet, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime, të qartësojë mbi ecurinë e trajtimit të praktikës pranë ILD-së, si dhe të depozitojë çdo dokumentacion provues mbi shpjegimet e dhëna.

**ii.** Subjekti, ndër të tjera në shpjegimet e saj, ka parashtruar: *“Mbi ecurinë e trajtimit të praktikës pranë ILD-së në lidhje me ankesën e shtetasës F. K. sqaroj se nuk kam dijeni në lidhje me ndonjë praktikë të ILD-së mbi ankesën e shtetasës F. K. . Për këtë arsye, me shkresën datë 1.7.2021, kam kërkuar informacion pranë ILD-së Tiranë, por deri në këtë moment nuk më është kthyer përgjigje nga Inspektorati”.*

Subjekti ka depozituar shkresën datë 1.7.2021, dëftesën e komunikimit datë 1.7.2021 dhe datë 5.7.2021.

**iii.** Trupi gjykues vëren se trajtimi i kësaj praktike është i ndërthurur ngushtësisht me çështjen e trajtuar hollësisht në germën “b/1.” më sipër. Arsyetimi i bërë ka ardhur si rezultat i analizimit të të dhënave të plota të administruara si, kallëzimi i shtetasve K., hetimet e kryera nga organi i Prokurorisë së Rrethit Fier, roli dhe funksioni i subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, ecuria e proceseve gjyqësore mbi ankimet e ushtruara nga këta shtetas, si dhe statusi aktual i çështjes.

Në kushte të tilla, kjo panoramë e plotë ezauron edhe trajtimin e kësaj praktike, duke arritur në konkluzion se nuk vërehen shkelje të kryera nga subjekti të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të saj.

**Në lidhje me denoncimet<sup>36</sup> e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar, si vijon:**

### **1. Denoncim<sup>37</sup> i shtetasit Th. Ç. (Th.Ç)**

Denoncimi i këtij shtetasi është trajtuar gjerësisht më sipër në këtë vendimarrje, më konkretisht në germën c/2. Trupi gjykues pasi vërejti se pretendimet e denoncuesit ishin të njëjta me ato të paraqitura edhe në praktikën e regjistruar pas ankesës së këtij shtetasi, sikurse është pasqyruar më sipër, për të mos rënë në përsëritje, vlerësoi që hetimin dhe konkluzionin përkatës ta parashtrrojë njëherazi në këtë rubrikë (c/2).

### **2. Denoncim<sup>38</sup> i shtetasit (D.M)**

Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit duke përmendur thjesht dhe vetëm identitetin e saj, ndërsa në parashtrime hedh dritë mbi një ngjarje për të cilën pretendon se pjesë e saj nuk ka qenë i biri, se për këtë të fundit akuza dhe pretenca janë të padrejta, por nuk pasqyron të dhëna apo indicie që të lidhin këtë çështje me rolin dhe pozicionin e subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi nuk ka depozituar asnjë dokument shoqërues.

Në kushte të tilla, trupi gjykues vlerëson se nuk shfaqen indicie që provojnë pretendimet e denoncuesit lidhur me shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

### **3. Denoncim<sup>39</sup> i shtetasit N. D.**

**i.** Denoncuesi ankohet për vendimarrje të padrejtë nga subjekti i rivlerësimit, pasi ka pushuar çështjen penale, duke e trajtuar çështjen të parashkruar sipas nenin 66/1 të Kodit të Procedurës Penale. Denoncuesi ankohet se subjekti e ka kanalizuar çështjen në parashikime ligjore të gabuara, sikurse është neni 290 i Kodit të Procedurës Penale. Ai ka sqaruar se procedimi penal ka ardhur si rezultat i përvetësimit të një pasurie nga të tretë në kundërshtim me ligjin, konkretisht, apartament i blerë nga vajza e tij në vitin 1996, ku shkak është bërë shkuarja në emigrim si familje në Greqi në vitin 1997 dhe kthimi i vonshëm në vitin 2011.

Në tërësi, duket se jemi përpara një konflikti pronësor, por që është ndërthurur edhe me procedimin penal.

**ii.** Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë për sa pretendohet në denoncimin e shtetasit N. D., të qartësojë statusin aktual të çështjes, si dhe të depozitojë dokumentacion në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

**iii.** Subjekti, ndër të tjera në shpjegimet e saj, ka sqaruar se: *“Në datën 1.3.2018 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit N. D., ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, i cili bën fjalë për veprën penale ‘falsifikim i dokumenteve’ dhe ‘shkatërrim prone’, parashikuar nga nenet 186 dhe 150 të Kodit Penal. Fakti i pretenduar nga kallëzuesi është se në vitin 1997 ai dhe bashkëshortja kanë emigruar në Greqi, ku kanë qëndruar për rreth 15 vjet. Në vitin 2001, kur është kthyer nga Greqia, ka konstatuar se ballkoni i shtëpisë ishte shkatërruar nga një shtesë që kishte bërë banori i katit të parë. Pas interesimit të tij ka mësuar se banori i katit të parë të pallatit, në të cilin ai banon, është shtetasi A.B., të cilin e ka pyetur pse ishte prishur ballkoni i shtëpisë së tij dhe B. i ka thënë se kishte*

<sup>36</sup> Ku dy prej tyre janë depozituar nga i njëjti person për të njëjtin objekt ankimi. Më konkretisht, denoncimi i shtetasit Ç. është trajtuar më sipër në këtë vendimarrje, ndërsa denoncimi i shtetasës R. I. është trajtuar nën titullin “Çështje të tjera”.

<sup>37</sup> Nr. \*\*\* prot, datë 01.10.2019

<sup>38</sup> Nr. \*\*\*prot, datë 30.09.2019

<sup>39</sup> Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2018.

*marrë një leje ndërtimi për të gjithë banorët e pallatit, por kishte bërë ndërtim vetëm ai, ndërsa banorët e tjerë të kateve të dytë, të tretë, etj. nuk kishin ndërtuar. Nga biseda me banorët e tjerë të pallatit ata i kanë konfirmuar se kishin dijeni se ishte dhënë një leje ndërtimi për shtesë pallati, por ata vetë nuk e kishin parë ndonjë leje të tillë. Pasi nuk e kishte siguruar lejen nga banorët e pallatit, kallëzuesi i është drejtuar Bashkisë Fier me kërkesë dhe nga bashkia i është vënë në dispozicion një leje ndërtimi me nr. \*\*\*, datë 17.4.2000. Në lejen e ndërtimit të administruar në bashki ai ka parë se në vend të vajzës së tij në këtë leje ndërtimi figuronte si pronar një shtetas, i quajtur V.V. P., i cili ka ndërruar jetë në vitin 1994. Leja e ndërtimit ka dalë në bazë të një deklaratë noteriale me nr. \*\*\* rep., datë 6.4.2000, e banorëve të pallatit, para noterit M.M., e cila sipas kallëzimit është e falsifikuar, pasi njëri nga deklaruësit figuron të jetë shtetasi V. P., i cili ka ndërruar jetë para hartimit të kësaj deklaratë. Po ashtu, sipas kallëzuesit, e falsifikuar është edhe vetë leja e ndërtimit, pasi një ndër personat për të cilët është dhënë kjo leje ndërtimi figuron të jetë V.Ç., i cili ka qenë banor i katit të tretë të pallatit, por jo në atë anë ku do të kryhej shtesa. Qëllimi i paraqitjes së këtij kallëzimi është që prokuroria të vërtetojë se dokumentet e mësipërme janë të falsifikuara dhe t'i jepet mundësia kallëzuesit dhe banorëve të tjerë të pallatit të marrin leje për të bërë shtesën, siç ka bërë edhe banori i katit të parë, i kallëzuar A. B. . Në lidhje me kallëzimin e shtetasi N. D. është vendosur mosfillimi i procedimit për arsye se: Sipas shkresës nr\*\*\*prot., datë 25.1.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Fier, dorëzuar nga kallëzuesi bashkë me kallëzimin, afati ligjor për kryerjen e punimeve për përmbushjen e kësaj lejeje ndërtimi ka mbaruar dhe në këto kushte leja e ndërtimit është e pavlefshme. [...] nuk mund të ushtrohet ndjekja penale, pasi nga kryerja e veprës penale deri në paraqitjen e kallëzimit kane kaluar 18 vjet, pra kanë kaluar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. I njëjti arsyetim është përdorur edhe për veprën penale 'shkatërrim prone', parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, për të cilën parashikohet dënim deri në tre vjet burgim. Dëmtimi i pasurisë së kallëzuesit është konstatuar prej tij në vitin 2001 dhe nga kjo kohë e deri në paraqitjen e kallëzimit janë plotësuar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale të parashikuar në nenin 66/1, germa 'c' e Kodit Penal. Kundër vendimit për mosfillimin e procedimit penal ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier shtetasi N.D. . Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.5.2018, i cili ka marrë formë të prerë në datën 15.5.2018, pa u ankimuar në apel, ka rrëzuar kërkesën e ankuesit N. D., duke lënë në fuqi vendimin datë 13.3.2018, për mosfillimin e procedimit penal nr\*\*\*, datë 1.3.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”.*

Subjekti ka depozituar aktet e kallëzimit penal nr. \*\*\*, datë 1.3.2018, si dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 3.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar në datën 15.5.2018.

**iv.** Trupi gjykues, në analizë të disa të dhënave të grumbulluara si: shpjegimet e dhëna nga subjekti në mënyrë kronologjike; verifikimi i dokumentacionit të depozituar; por nisur edhe nga fakti se denoncuesi në këtë çështje të pretenduar ka ushtruar të drejtën e tij të ankimit mbi vendimmarrjen e subjektit – nuk vëren problematika të cilat ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

#### **4. Denoncim i shtetases Zh. Q.**

**i.** Denoncuesja ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit, duke pretenduar se me pa të drejtë ka pushuar çështjen penale (për të cilën nuk jep të dhëna konkrete). Ndër të tjera, pretendon se eksperti i thirrur nga subjekti i rivlerësimit për të kryer aktekspertimin, shtetasi F. P., ka qenë në konflikt interesi, pasi ka qenë nëndrejtor i hipotekës dhe se dokumentet false të palës

kundërshtare kanë dalë nga ZVRPP-ja Fier. Në vijim, denoncuesja shtjellon shkeljet e kryera në procesin gjyqësor nga të tjerë subjekte rivlerësimi.

Denoncuesja nuk ka bashkëlidhur dokumente mbi pretendimet e parashtruara.

**ii.** Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime të detajuara mbi pretendimet e denoncueses, si dhe të depozitohet çdo dokumentacion që provon argumentet e dhëna.

**iii.** Subjekti, ndër të tjera në shpjegimet e saj, ka sqaruar se: *“Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e kallëzimit të shtetasve L. Q. e S. Q., në datën 6.10.2008 ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, i cili bën fjalë për veprën penale ‘shkatërrim prone’, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Ankuesja Zh. Q. është bashkëshortja e kallëzuesit S. Q.”.*

Ndër të tjera, subjekti shpjegon se: *“Me vendimin për zëvendësimin e prokurorit, datë 11.9.2017, është ngarkuar për vazhdimin e hetimeve të këtij procedimi. Kallëzuesit S. Q. e L. Q. kanë pretenduar se shtetasi S. B. ka ndërtuar ngjitur me shtëpinë e tij një ndërtesë në kundërshtim me ligjin, duke dëmtuar pasurinë e tyre gjatë këtyre ndërtimeve. Po ashtu, ata kanë pretenduar se shtetasi S. B. u ka përvetësuar edhe truallin, ku pasuria me nr. \*\*\*, që është pasuria e tyre, i ka kaluar shtetasit S. B. me anë të dokumenteve të falsifikuara, ku ish in implikuar persona të Zyrës së Hipotekës Levan dhe Fier. Me vendimin e prokurorit, të datës 9.1.2013, është vendosur pushimi i procedimit. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier kallëzuesi dhe kjo gjykatë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.5.2013, i cili ka marrë formë të prerë me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.10.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë, ka vendosur: ‘Pranimin e kërkesës; prishjen e vendimit të datës 9.1.2013, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier ‘Për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*’; urdhërohet Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier të vazhdojë hetimet në lidhje me veprën penale ‘falsifikim i dokumenteve’, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal’. Gjatë arsyetimit të vendimit, nga ana e gjykatës është konstatuar se pretendimet e kallëzuesit kanë të bëjnë jo vetëm me dëmtimin e shtëpisë së kallëzuesit, por edhe me atë të marrjes pa të drejtë të sipërfaqes së tokës, ku është bërë ndërtimi nga shtetasi S. B., duke pretenduar se ajo ka qenë tokë e tij dhe se personi i interesuar nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara ia ka përvetësuar. Gjykata ka evidentuar edhe në lidhje me falsifikimin e dokumenteve të përdorura nga shtetasi S. B. [...]. Gjykata ka përcaktuar kryerjen e disa detyrave që duhet të kryhen nga organi i prokurorisë. Duke u ndodhur përballë faktit se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka marrë formë të prerë, duke u lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlore dhe duke mos u pranuar rekursi i ushtruar nga prokurori, organi procedues ka rifilluar hetimet, në mënyrë që të kryejë detyrat e lëna nga gjykata, e cila ka urdhëruar prokurorinë për vazhdimin e hetimit në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Ndër detyrat e caktuara nga gjykata është edhe kryerja e ekspertimit topografik, me anën e të cilit do të ballafaqoheshin dokumentet e paraqitura nga i kallëzuesi, me dokumentet përkatës që ZVRPP-ja dispononte në lidhje me objektin e kallëzimit. Për zbatimin e kësaj detyre të caktuar nga gjykata, oficeri i policisë gjyqësore i ngarkuar me hetimin e çështjes (dhe jo prokurorja, siç pretendon denoncuesja) ka vendosur kryerjen e ekspertimit, duke caktuar si ekspert z. F. P., ekspert i licencuar. Pretendimi i ankueses se F.P. ka qenë në konflikt interesi, pasi ka qenë nëndrejtor i hipotekës dhe se dokumentet false të palës kundërshtare kanë dalë nga ZVRPP-ja Fier, janë të pambështetura në ligj. Në lidhje me ekspertin F. P. nuk janë të pranishme asnjë nga shkaqet e parashikuara në ligj (nenet 15-17 të Kodit të Procedurës Penale) për përjashtimin e ekspertit. Nga këqyrja e dosjes hetimore rezulton se eksperti F. P., gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me administrimin e dokumentacionit apo regjistrimin e pasurisë, objekt konflikti. Po ashtu, oficeri i policisë gjyqësore ka njohur me vendimin për kryerjen e ekspertimit kallëzuesin S. Q. (bashkëshorti i denoncueses), i cili nuk ka paraqitur asnjë pretendim në lidhje me ekspertin e caktuar. Sipas aktit të ekspertimit topografik të ekspertit, ing. F. P., është arritur*



*në konkluzionin se nga krahasimi i listës emërore të paraqitur nga shtetasi S.B. dhe planvendosjes në dokumentet e regjistrimit të pronës me listën e ndodhur në komunën Levan dhe në arkivën e ZVRPP-së Fier, vihet re se ka ndryshime në numrin e pasurisë dhe në sipërfaqen e truallit dhe të banesës. [...] eksperti, ndër të tjera, ka arritur në konkluzionin se shtetasi S. B., bashkëlidhur me dokumentacionin për legalizim, ka paraqitur në zyrën e ALUIZN-it Fier një hartë treguese, e cila mban firmat dhe vulën e institucionit të ZVRPP-së Fier, por ka të pasqyruar të dhëna jo të njëjta me hartën me të cilën ky shtetas është pajisur nga zyra e regjistrimit, bashkëngjitur certifikatës së pronësisë së tij mbi banesën dhe truallin. Mbi këtë bazë, por edhe nga hetimet e kryera, është arritur në konkluzionin se shtetasit I. M. dhe A.Q. kanë kryer veprën penale 'falsifikim i dokumenteve', parashikuar nga nenet 186/3 dhe 25 të Kodit Penal dhe shtetasi S.C. (S. B.) ka kryer veprën penale 'falsifikim i dokumenteve', parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, por duke iu referuar datës së lëshimit të këtyre dokumenteve dhe më pas përdorimit prej tyre, nga shtetasi S. C. është konkluduar se janë parashkruar afatet e ndjekjes penale të parashikuara nga neni 66/1 i Kodit Penal. Nga ana e organit procedues, në datën 5.2.2018 është paraqitur kërkesa për pushimin e procedimit penal nr\*\*\*, kërkesë e cila është miratuar edhe nga gjykata. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.4.2018, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 6.10.2018, për veprën penale 'falsifikim i dokumenteve', për shkak të plotësimit të afateve të parashkrimit të ndjekjes penale. Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë në datën 5.6.2018, pa u ankimuar në apel”.*

Subjekti ka depozituar: vendimin nr. \*\*\*, datë 24.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; vendimin për kryerjen e ekspertimit topografik të oficerit të policisë gjyqësore R.Z.; praktikën e dërguar nga ZVRPP-ja Fier, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 25.2.2019; si dhe vendimin nr\*\*\*, datë 30.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

**iv.** Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të depozituar, vëren se në këtë rast subjekti ka kryer veprimet e plota hetimore pas kthimit të çështjes nga gjykata, vendim për të cilin denoncuesi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit.

## **5. Denoncim<sup>40</sup> i shtetases R.I.**

Lidhur me këtë denoncim, përveçse më sipër në këtë rivlerësim profesional të subjektit janë dhënë disa detaje, Komisioni e ka hetuar dhe trajtuar këtë çështje hollësisht në vijim, nën titullin “Çështje të tjera”, për arsye se është bërë prezent edhe mediatikisht në një ndër emisionet investigative në TV Klan.

## **6. Denoncim<sup>41</sup> i shtetasit S. A.**

**i.** Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit, por edhe ndaj subjekteve të tjera, për shpërdorim detyre, fshehje të provave, moshetime të plota të çështjes, si dhe për njëanshmëri. Denoncuesi, në ankimin e tij, jep kryesisht të dhëna për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe për shkelje të kryera nga gjyqtarja gjatë procesit, por nuk duket se jep të dhëna apo detaje mbi pretendimet për shkelje nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi ka depozituar vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 3.5.2018, disa kërkesa drejtuar institucioneve të ndryshme në vend, si dhe kërkesën e subjektit për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*. Denoncuesi nuk jep të dhëna nëse ka ushtruar ankim ndaj vendimit gjyqësor dhënë mbi kërkesën e organit të prokurorisë.

Ndër të tjera, në këtë kërkesë diktohet se denoncuesi ka kallëzuar shtetasin I.A. për ushtrim të veprimtarisë tregtare të palicencuar, se nuk është i pajisur me kasë fiskale dhe se ushtron veprimtari pune në një objekt të paligjshëm. Denoncuesi pretendon se ka fituar tokën nën

<sup>40</sup> Denoncim nr. \*\*\*prot., datë 21.3.2019, dhe nr\*\*\*prot., datë 31.10.2018.

<sup>41</sup> Denoncim nr. \*\*\*prot., datë 25.7.2018.

ndërtim (objektin ku ushtron veprimtarinë tregtare i kallëzuari) me vendim të formës së prerë dhe se titullarë të INUV-it nuk kanë bërë të mundur lirimin e pronës së tij. Konkretisht, ai ka kallëzuar për shpërdorim detyre shtetasin H.Ç., me detyrë drejtor i INUV-it pranë Bashkisë Fier, pasi nuk ka prishur një ndërtim pa leje. Nga hetimet ka rezultuar se në kërkesën e prokurores i kallëzuari është i regjistruar për ushtrim aktiviteti dhe disponon fatura të blerjes së mallit, por lëshon edhe kupon tatimor në momentin e kontrollit. Në përfundim të veprimeve hetimore, subjekti ka kërkuar pushimin e çështjes penale për veprat penale “moslëshim të kuptonit tatimor”, “shpërdorim detyre”, si dhe “falsifikim të dokumenteve”. Lidhur me shpërdorimin e detyrës, subjekti, në kërkesën për pushim pasqyron veprimet hetimore në lidhje me pyetjen e shtetasit H. Ç., parashtrohet problematikat e shfaqura nga kallëzuesi dhe i kallëzuari, të cilët janë kushërinj dhe se pretendojnë të njëjtën pronësi mbi të njëjtën vendimmarrje gjyqësore, për të cilën drejtuesi i INUV-it ka sqaruar se derisa të zgjidhen konfliktet gjyqësore mes të dy palëve që kanë konflikte të ndërsjella, nuk mund të ndërhyhet në prishjen e objektit. Më tej, konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin datë 3.5.2018, ka vendosur pushimin e kërkesës së prokurorisë për procedimin e lartpërmendur.

**ii.** Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të qartësojë nëse ndaj vendimit gjyqësor është ushtruar ankim dhe cili është statusi aktual i çështjes gjyqësore, si dhe të depozitojë dokumentacion në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

**iii.** Subjekti, ndër të tjera në shpjegimet e saj, ka sqaruar se me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është pranuar kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, datë 25.1.2018, “Për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 29.6.2017”. Shtetasi S. A. ka paraqitur ankim kundër vendimit nr.\*\*\*, datë 3.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.7.2028, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 3.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Subjekti ka depozituar kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, vendimin nr. \*\*\*, datë 3.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

**iv.** Trupi gjykues vlerëson të plotë dhe të provuar qartësimin e subjektit lidhur me ecurinë e statusit të kësaj çështjeje dhe njëkohësisht nuk vëren ndonjë problematikë procedurale ligjore që ndikon në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

## **7. Çështje të tjera**

**7.1** Komisioni, nisur nga një çështje e bërë mediatike, ka administruar dhe analizuar fashikullin penal<sup>42</sup> që i përket vendimit datë 25.5.2017. Nga aktet e administruara ka rezultuar, si vijon:

**7.1.1** Subjekti i rivlerësimit, me vendimin datë 25.5.2017, ka vendosur: Pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, për veprën penale “ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i dytë i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit G. B.; si dhe dërgimin e një kopjeje të vendimit ministrit të Drejtësisë për njoftim dhe vlerësim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve G. B. dhe B. Ç. .

**7.1.2** Sipas të dhënave në fashikull, çështja ndodhet në Gjykatën e Lartë mbi rekursin e ushtruar nga shtetasja R. I. .

**7.1.3** Sipas dokumentacionit të administruar rezulton se vendimi i pushimit të procedimit penal është ankimuar.

---

<sup>42</sup> Dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 12.5.2021.

**7.1.4** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.7.2018, ka vendosur: Prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, duke lënë disa detyra për t'u kryer (hetime të mëtejshme nga organi i akuzës).

**7.1.5** Mbi këtë vendimmarrje është ankuar organi i akuzës (subjekti i rivlerësimit).

**7.1.6** Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.9.2018, ka vendosur: Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe rrëzimin e ankimit të ankueses R. I. .

**7.1.7** Në datën 3.2.2017 subjekti i rivlerësimit ka vendosur për pranimin e akteve të procedimit penal nr\*\*\*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për veprën penale “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, dërguar për kompetencë lëndore nga kjo prokurori.

## **7.2 Rrethanat e çështjes në tërësi**

**i.** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka urdhëruar në datën 27.10.2016 regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit G.B., bazuar në të dhënat e siguruar nga emisioni investigativ “Stop”, transmetuar në TV Klan në datën 27.10.2016. Po në këtë datë i është dërguar urdhërimi i regjistrimit edhe TV Klan.

**ii.** Programi ka prezantuar një rast të pretenduar korrupsioni të shfaqur në formën e një regjistrimi audio, në të cilin përfshihej shtetasja e identifikuar R. I. dhe personi i dyshuar si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, G. B. .

**iii.** Shtetasja R. I. ka pasur më parë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë një çështje me objekt “lëshim urdhër mbrojtje”, seancë e zhvilluar nga gjyqtar G. B. . Më pas kjo shtetase ka vijuar me një tjetër proces gjyqësor civil, gjykuar me një tjetër gjyqtare, me objekt “lirim e dorëzim sendi”, me familjarë të bashkëshortit të saj, ku edhe rezulton gjyqhumbëse. Në gjykimin e kësaj çështjeje pretendohet se do të ndërhyhej nga kryetari (asokohe) G. B. në këmbim të favoreve seksuale të kërkuara prej këtij të fundit. Shtetasja R. I., pas humbjes së procesit gjyqësor deri edhe në apel, ka vijuar takimet me shtetasin G.B., me qëllim regjistrimin e bisedës mes tyre dhe konfirmimin e bisedave dhe kontakteve të tyre të mëparshme me qëllim vërtetimin e ekzistencës. Pasi ka kryer regjistrimet edhe me gjyqtaren e gjykimin të çështjes, shtetasja R.I. është paraqitur pranë TV Klan, ku ka dorëzuar regjistrimet e pandërprera në zyrat e emisionit investigativ “Stop”.

**iv.** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka vlerësuar se nuk ndodhemi përpara përbushjes së elementëve të veprës penale të “Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, por përbushen plotësisht elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

**v.** Çështja fillimisht është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe është hetuar për mbi dy muaj nga një tjetër subjekt rivlerësimi (P. P.).

**vi.** Me vendimin e datës 15.1.2017 është vendosur “Zgjatja e afateve të hetimit me dy muaj” për t'u kryer aktekspertimi grafik lidhur me fletët A4 të sekuestruara nga shtetasja R. I. (është pretenduar se fletët kanë qenë të shkruara nga shtetasi G. B. për të ndihmuar shtetasin R. I. për mënyrën dhe qëndrimin që duhet të mbante ajo dhe avokatja në gjykimin e çështjes civile).

**vii.** Në datën 18.1.2017 prokurorja P. P. ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore për hetim paraprak të procedimit penal nr\*\*\* dhe kalimin e akteve të këtij procedimi Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Në vendimin e lartpërmendur është pasqyruar:

- vendimi<sup>43</sup> i prokurorit për sekuestrimin e pamjeve filmike;
- vendimi<sup>44</sup> i prokurorit për kryerjen e aktit të ekspertimit teknik të DVD-ve;
- vendimi<sup>45</sup> për sekuestrimin e pamjeve filmike të plota të transmetuara në emision;
- procesverbali<sup>46</sup> për këqyrjen dhe marrjen e provës, vendimin gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 21.5.2015;
- procesverbali<sup>47</sup> për sekuestrimin e formateve A4, së bashku me këto të fundit;
- procesverbali<sup>48</sup> për marrjen e modeleve të shkrimit;
- marrja në pyetje e shtetasës R.I., me cilësinë e personit që ka dijani për çështjen;
- marrja në pyetje<sup>49</sup> e shtetasës Ç. (gjyqtarës së gjykimit civil), me cilësinë e personit që ka dijani për veprën penale;
- marrja në pyetje<sup>50</sup> e shtetasit G. B., me cilësinë e personit nën hetim (për të cilin thuhet se ka mohuar çdo lloj kontakti, takimi apo lidhje me shtetasen R. I.);
- konkludimet e aktekspertimit lidhur me dy DVD-të, objekt ekspertimi, kryer nga ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore;
- arsyet se përse është ndryshuar cilësimi i veprës penale *në ushtrimin e ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*, duke cilësuar, ndër të tjera, ndikimin e pozicionit të z. G. B. si kryetar i gjykatës tek gjyqtarja që kishte çështjen civile me palë ndërgjyqëse shtetasen I. .

Nga aktet e administruara, as në vendim nuk pasqyrohet kryerja e aktekspertimit grafik për fletët A4, detyrë e cila u vlerësua nga prokurorja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe për pasojë u bë shkak për zgjatjen e afateve të hetimit.

**viii.** Zgjatja e hetimeve duket se e kishte humbur qëllimin e saj, pasi vetëm tre ditë pas vendimmarrjes, pa u përmbushur detyra e lënë, është ndryshuar cilësimi juridik i veprës penale dhe, për pasojë, çështja i ka kaluar për kompetencë lëndore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

**ix.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (për shkak të transferimit të dosjes për kompetencë lëndore) ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit G. B. .

**x.** Në vijim, në datën 9.3.2017 subjekti i rivlerësimit ka vendosur kryerjen e aktekspertimit teknik grafik, duke thirrur si ekspertë specialistë të Drejtorisë së Policisë Shkencore Tiranë.

**xi.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 27.3.2017 ka vendosur zgjatjen e afateve të hetimit deri në më 27.6.2017, me qëllim administrimin e aktekspertimit, pasi nuk kishte përfunduar së kryeri disa hetimeve të tjera (f. 379).

<sup>43</sup> Datë 27.10.2016, numërtuar në fashikull me f. 33.

<sup>44</sup> Datë 12.12.2016, numërtuar në fashikull me f. 36.

<sup>45</sup> Datë 2.11.2016, numërtuar në fashikull me f. 39.

<sup>46</sup> Datë 28.10.2016, numërtuar në fashikull me f. 44.

<sup>47</sup> Datë 18.11.2016, numërtuar në fashikull me f. 64.

<sup>48</sup> Datë 30.11.2016, numërtuar në fashikull me f. 68.

<sup>49</sup> Datë 3.11.2016, numërtuar në fashikull me f. 174.

<sup>50</sup> Datë 4.11.2016, numërtuar në fashikull me f. 177.

**xii.** Në datën 30.3.2017 është mbajtur procesverbal për deklarimet nga shtetasi G. B., si personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet (f. 375).

**xiii.** Në datën 31.3.2017 është mbajtur procesverbal për rimarrjen e të dhënave nga shtetasja M., si personi që ka dijeni për veprën penale (f. 377).

**xiv.** Në dosje është administruar aktekspertimi datë 4.5.2017.

**xv.** Nga verifikimi i konkluzioneve të përshkruara nga ekspertët vërehet se rast pas rasti nuk përjashtohet mundësia që dorëshkrimet të jenë shkruar nga këta shtetas, sikurse edhe rastet e pasqyruara se nuk duhet të jenë shkruar prej tyre.

**xvi.** Në datën 19.5.2017 është hartuar nga OPGJ-ja relacioni mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve të këtij procedimi, ku edhe është sugjeruar pushimi i çështjes (f. 383).

**xvii.** Në datën 14.2.2019 rezulton se Prokuroria e Rrethit Fier i ka dërguar Gjykatës së Lartë aktekspertimin akustik bisede nr. 2.1/201925, datë 21.1.2019 (në origjinal), dorëzuar në prokurori nga gazetari i emisionit investigativ “Stop”.

**xviii.** Emisioni investigativ, në datën 14.10.2019, i ka bërë me dije kësaj prokurorie disa shkelje të evidentuara gjatë monitorimit të hetimit të çështjes, duke pasqyruar, ndër të tjera, edhe se KLD-ja i kishte lënë detyrë prokurorisë realizimin e aktekspertimit audio<sup>51</sup>.

**xix.** Nga sa arsyetohet më sipër, vërehet se përfaqësuesi i emisionit investigativ ka depozituar kërkesa pranë KLD-së dhe organit të Prokurorisë së Rrethit Fier pas përfundimit të hetimeve nga kjo e fundit, si dhe pas marrjes së vendimit të pushimit.

**xx.** Nga sa më sipër, në tërësi duket se subjekti i rivlerësimit ka vijuar hetimet në fazën ku janë lënë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Fillimisht rezulton se ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale është konkluduar nga kjo e fundit.

**xxi.** Për këtë çështje, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime të detajuara lidhur me hetimet e kryera në raport me ndryshimin e cilësimit të veprës penale nga ajo e “korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, në “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

**xxii.** Subjekti, ndër të tjera në shpjegimet e saj, ka sqaruar se: *“Procedimi penal nr. \*\*\*, në ngarkim të shtetasit G. B., me detyrë kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, është regjistruar mbi bazën e akteve të procedimit penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, dërguar për kompetencë nga kjo e fundit. Procedimi penal është regjistruar për veprën penale ‘ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike’, parashikuar nga neni 245/1, paragrafi 2 i Kodit Penal. Nga ana ime, si prokurore e çështjes, nuk janë kryer hetime në raport me ndryshimin e cilësimit të veprës penale nga ajo e ‘korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë’, parashikuar nga neni 319 në veprën penale ‘ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike’, parashikuar nga neni 245/1, paragrafi 2 i Kodit Penal, pasi këtë ndryshim, siç e sqarova, e kishte kryer Prokuroria për Krime të Rënda, duke konstatuar moskompetencën e saj dhe duke i dërguar aktet e procedimit për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Hetimet e kryera kanë pasur për qëllim hetimin e plotë të çështjes dhe jo ndryshimin e cilësimit juridik, pasi ky ndryshim është bërë nga Prokuroria për Krime të Rënda, sipas arsyetimit në*

---

<sup>51</sup> Gjithashtu, emisioni, nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë, ka kërkuar në vitin 2019 pranë kësaj prokurorie vënien në dispozicion të dokumentacionit që i përket këtij procedimi.

*vendimin 'Për shpalljen e moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve, datë 18.1.2017'. Nga ana e organit procedues është vendosur kryerja e ekspertimit teknik grafik, për të provuar se provat shkresore të paraqitura nga shtetasja R.I. ishin plotësuar nga personi nën hetim G. B. apo nga gjyqtarja e çështjes B. Ç. . Për këtë qëllim janë marrë modelet eksperimentale të shkrimit të shtetasve G.B. e B.Ç., por Instituti i Policisë Shkencore Tiranë nuk e ka kryer aktin e ekspertimit, duke kërkuar modele të lira të shkrimit të këtyre shtetasve. Për këtë arsye janë kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë modele të lira të shkrimit të shtetasve G. B. e B.Ç. . Po ashtu, për këtë qëllim janë ripyetur këta shtetas për të paraqitur modele të shkrimit të tyre, për të mundësuar kryerjen e ekspertimit grafik e teknik të shkrimit. Modele të lira të shkrimit nuk është bërë e mundur të sigurohen, por vetëm modele të nënshkrimit, të cilat janë vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Nga ana e ekspertëve të Drejtorisë së Policisë Shkencore është kryer akti i ekspertimit grafik e teknik”.*

**xxiii.** Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna, dokumentacionit të depozituar, por edhe në tërësi të pasqyrimin të kësaj çështjeje, vëren se zanafilla e saj ka nisur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe që për pasojë veprimet e subjektit të rivlerësimit për t’u kryer në këtë rast kanë qenë të pasqyruara në transferimin e çështjes pranë organit të Prokurorisë së Rrethit Fier. Pra, parë në kontekstin e ushtrimit të rolit dhe punës së subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, konstatohet se janë vlerësuar dhe ndërmarrë veprimet e caktuara hetimore, pas të cilave është rezultuar edhe me vendimmarrjen përkatëse. Nga njëra anë, fakti që gjykatat përkatëse mbi ushtrimin e ankimit të vendimit të subjektit të rivlerësimit janë ndarë në vendimmarrjet e tyre dhe, më konkretisht, fakti që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka prishur vendimin e subjektit të rivlerësimit për pushimin e çështjes, duke pranuar kthimin e saj pranë organit të prokurorisë dhe vijimin e kryerjes së disa detyrave të tjera, ndërsa Gjykata e Apelit Vlorë, mbi bazë të ankimit të subjektit të rivlerësimit, ka lënë në fuqi vendimmarrjen e këtij të fundit duke prishur vendimin e shkallës së parë, por edhe për arsye se nga analizimi i procedurës hetimore pa cenuar logjikën e subjektit të rivlerësimit, nuk u vërejt ndonjë shkelje procedurale, ndërthurur këto detaje edhe me të qenurit e çështjes ende në proces gjyqësor, e vendosin trupin gjykues jashtë sferës dhe kompetencës ligjore për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi. Në kushte të tilla, çështja në fjalë çmohet se nuk ndikon në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Sipas dispozitave të pikës 1, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: *“Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.*

Pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, përcakton: *“Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën”.*

Pika 4 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, përcakton: *“Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”.*

### **Trupi gjykues, duke pasur në konsideratë:**

- pikën 1, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të*

*kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”;*

- nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “*Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues*”;
- vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet: “[...] në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht ‘të pasakta’ nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL - AD (2016)036 të Komisionit të Venecias);
- nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë – **arsyeton se:**

Mangësitë e konstatuara në çështjet e numërtuara b/3 dhe c/3, në rubrikën e rivlerësimit profesional, nuk janë të mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka një mënyrë/praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e tij.

Sa më sipër, si dhe për shkak të kufizimit për të mos zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit, trupi gjykues vlerëson se vetëm mangësitë e gjetura për sa më sipërarsyetuar mund të përbëjnë shkaqe për procedim disiplinor të tij, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, për t’u vlerësuar më tej nga organi kompetent.

### **Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues i Komisionit**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Elida Hoxhaj, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se dërgimi për inspektim i çështjeve të hetuara nga subjekti janë të pamjaftueshme për të arritur në vlerësimin e tij, sipas germave “b” dhe “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues, sipas nenit 44/a dhe nenit 59/c të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr.

84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

#### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elida Hoxhaj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Transferimin e çështjes penale që u përket procedimeve penale nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.7.2021.

#### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
**Kryesuese**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*